

1 E premte, 16 qershor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

4 --- Fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita dhe mirë se keni ardhur.

7 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Kjo është lënda me numër

9 KSC-BC-202-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së

11 pari dëshiroj që të prezantohen të pranishmit.

12 Z. Prokuror, e keni fjalën

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

14 Kemi Line Pedersen, Gaia Pergolo dhe Filippo De Minicis në

15 emër të ZPS-së.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Mbrojtësi i Viktimave.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Unë

20 jam Simon Law, Mbrojtës i Viktimave në këtë çështje gjyqësore.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Mbrojtja.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita. Jam Jean Louis

25 Gilissen. Jam bashkë me Aidi Aouini dhe znj. Cariolou. Z.

1 Shala është i pranishëm përmes videolidhjes. Pastaj kemi dhe
2 të pranishëm nga ekipi ynë, Kailin Chen dhe Judit Kolbe si dhe
3 Juliette Healy, ndihmëse për shqyrtimin e provave.
4 Faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Nga Zyra Administrative kemi një përfaqësues. Keni
8 fjalën.

9 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Si i
10 pranishëm në sallën e gjyqit, jam Ralph Roche në emër të Zyrës
11 Administrative. Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të
15 radhës që është Zbynek Dolejsi, duhet që të trajtojmë disa
16 çështje procedurale.

17 Për këtë duhet të kalojmë fillimisht në seancë private
18 lidhur me faktin që duhet të vendosim në procesverbal një
19 urdhër të bërë përmes postës elektronike këtë javë, të
20 mërkurën, më 14 qershor 2023.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
17 të nderuar Gjykatës.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit znj. Sekretare.

20 Përfaqësuesi i Zyrës Administrative nuk do të jetë më i
21 pranishëm në seancë. Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj.

22 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi

24 një urdhër të dytë për të dhënë gojarisht. I kemi informuar

25 palët dhe Mbrojtësin e Viktimave lidhur me këtë. Ka të bëjë me

1 parashtrimin e protokolluar 547, të dorëzuar më 14 qershor dhe
2 shpërndarë dje.

3 Në të Mbrojtja kërkon zgjatje me pesë ditë të afatit
4 kohor për të dorëzuar kërkesën e saj për leje për apelim të
5 vendimit të Trupit Gjykses, në lidhje me mocionin e
6 Prokurorisë për konstatim gjyqësor të fakteve që dihen
7 gjerësisht dhe të fakteve të gjykuara.

8 Ky është dorëzuar dje -- ZPS-ja - më falni ka komunikuar
9 se nuk synon që të dorëzojë një përgjigje në përgjigje të
10 kësaj kërkesë.

11 Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja ka treguar arsye të
12 vlefshme siç e kërkon rregulla 95(a) e Rregullores. Në veçanti
13 Mbrojtja ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme se ekziston
14 nevoja për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e
15 kërkesës për leje për apelim. Ndërkohë që duhet të respektojë
16 një sërë afatesh të tjera të cilat përplasen me këtë.

17 Trupi Gjykses gjykon se kjo zgjatje e kërkuar e afatit
18 nuk përbën vonesë të panevojshme në procedurë. Trupi Gjykses
19 rrjedhimisht e miraton kërkesën dhe rrjedhimisht e ndryshon
20 afatin kohor për Mbrojtjen për të dorëzuar kërkesën për leje
21 për apelim të vendimit 538 në ditën e enjte, 22 qershor 2023.

22 Ky mbyllet ky urdhër i dytë i dhënë gojarisht.

23 Pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të radhës,
24 Trupi Gjykses do të lëshojë një urdhër të tretë gojarisht
25 lidhur me një dokument tjetër i cili është nxjerrë nga ZPS-ja

1 dje.

2 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e z. Dolejsi. Z. Dolejsi
3 do të dëshmojë pa masa mbrojtëse këtu në sallë. Megjithatë,
4 pjesë të dëshmisë së tij mund të zhvillohen në seancë private
5 nëse ekziston nevoja për të mbrojtur identitetet e
6 dëshmitarëve të tjerë dhe të viktimave që rrezikohen nga kjo
7 dëshmi lidhur me bashkëpunimin e tyre me Dhomat e
8 Specializuara

9 Do të bëjmë tri seanca të rregullta nga një orë e gjysmë
10 me pushimin 30-minutësh. Sa i takon drekës në orën 1.00 do të
11 shikojmë se ku jemi me dëshminë dhe në bazë të kësaj, do të
12 bëjmë pushim ose një orë ose një orë e gjysmë, pra, pushimin e
13 drekës, e kam fjalën dhe për të parë nëse do të na duhet për
14 të shtuar një seancë 45-minutëshe apo jo. Të shohim sesi do të
15 vazhdojmë.

16 Shumë mirë. Znj. Asistente e sallës ju lutem shoqërojeni
17 dëshmitarin që të hyjë në sallë.

18 Z. Prokuror

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndërkohë që hyn dëshmitari në
20 sallë ne do të bëjmë çmos që ta bëjmë sa më shumë në seancë
21 publike pyetjet tona dhe mendojmë se këtë mund ta bëjmë
22 thjesht duke folur në seancë publike me dëshmitarin duke
23 përmendur dy tema të raportit me anë të një pseudonimi. Të
24 paktën sa i takon pyetje që do t'i bëjmë dëshmitarit që ne e
25 kemi thirrur, ne do të përpiqmi që t'i bëjmë në seancë publike

1 pa pasur nevojë që t'i bëjmë këto pyetje në seancë private.

2 Kështu propozojmë ne.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Dëshmitar, mund të uleni.

8 Z. Dolejsi, mirëdita. Mirë se keni ardhur në Dhomat e

9 Specializuar. A jua shqiptova mirë emrin?

10 DËSHMITARI: [Përkthim] [Nuk ka përkthim]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

12 rregull, Zbynek Dolejsi.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Dolejsi.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Thjesht desha të sigurohesha nëse e kam shqiptuar mirë emrin.

16 Më dëgjoni mirë? Vura re që më dëgjoni mirë.

17 Z. Shala e dëgjoni dëshmitarin?

18 Z. SHALA: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj. Po e

19 ndëgjoj mirë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit. Faleminderit.

22 Z. Dolejsi, si jeni?

23 Do të bëjmë një ndërprerje të vogël sepse kishim një

24 defekt teknik.

25 Tani duhet të jetë në rregull. Do të vazhdojmë.

1 Z. Dolejsi, kishim një problem të vogël teknik, por besoj
2 se është zgjidhur tani. Sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj.
3 Përpara se të filloj kam disa gjëra për t'jua thënë.

4 Ju kanë thirrur që të dëshmoni përpara Dhomave të
5 Specializuara në çështjen gjyqësore të z. Pjetër Shala për të
6 ndihmuar këtë Trup Gjykses që të marrë një vendim. Fillimisht
7 do të bëni betimin solemn pas të cilit ju do të dëgjoni
8 pyetjet, pra do t'ju përgjigjeni pyetjeve, fillimisht të
9 përfaqësues të Prokurorit të Specializuar, personat të cilët
10 në sallë kanë pelerinën me shiritin ngjyrë vjollcë. Pastaj
11 Përfaqësuesi i Viktimave, Mbrojtësi i Viktimave që përfaqëson
12 viktimat që marrin pjesë në këtë çështje gjyqësore. Pastaj do
13 t'ju bëjë pyetje ekipi i Mbrojtjes, ata që kanë pelerinën me
14 shiritin e kuq. Dhe në fund nëse do të jetë e nevojshme -- në
15 fund gjithashtu mund t'ju bëjë pyetje edhe Trupi Gjykses.

16 Do t'ju jap disa udhëzime sa i takon dëshmisë tuaj z.
17 Dëshmitar. Z. Dolejsi ju lutem dëgjojeni me vëmendje çdo
18 pyetje. Nëse nuk e kuptoni lirisht mund të kërkonit që pyetjen
19 t'jua sqarojnë apo t'jua përsëritin.

20 Dëshirojmë që të jepni ekspertizën tuaj në bazë të
21 njohurive tuaj më të mira dhe të deklaroni se cilat janë
22 konstatimet dhe mendimet tuaja.

23 Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve që jua bëjnë. Nëse
24 nevojiten sqarime të më tutjeshme do t'ju kërkohet edhe kjo
25 gjë.

1 Dua t'ju jap edhe disa këshilla praktike z. Dolejsi. Çdo
2 gjë që ne themi këtu përkthehet dhe regjistrohet. Prandaj edhe
3 është e rëndësishme që të flisni sa më pranë mikrofonit, të
4 flisni qartë, dhe të flisni ngadalë. Kjo do t'u japë
5 përkthyesve që të përkthejnë gjithçka.

6 Duhet të filloni të flisni vetëm pasi të ketë përfunduar
7 pyetja që jua bëjnë. Kur përfundon pyetja ju lutem, prisni
8 pesë sekonda përpara se të filloni të përgjigjeni. Kjo u jep
9 mundësi përkthyesve që të finalizojnë përkthimin.

10 Nëse do të ngre dorën, ju lutem mos flisni më. Ndonjëherë
11 mund t'ju kërkojmë që të dilni nga salla e gjyqit nëse do të
12 na duhet të diskutojmë diçka lidhur me përmbajtjen e dëshmisë
13 suaj, në mënyrë që të shmangim influencën në përgjigjen tuaj.
14 Shoh që po pohoni me kokë? Po të keni ndonjë pyetje po të keni
15 për pushim apo po të keni ndonjë nevojë tjetër, ju lutem
16 mjafton të ngrini dorën dhe do t'jua jap fjalën.

17 I kuptuat të gjitha këto?

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull. Z. Dolejsi, do t'ju kërkoj tani që të bëni betimin
21 solemn. Ju rikujtoj se përbën vepër penale brenda
22 juridiksionit të Dhomave të Specializuar dhënia e dëshmisë së
23 rreme.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e di.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë. Tani z. Dolejsi do t'ju kërkoj që të bëni betimin

2 solemn. Ju lutem përsërisni pas mije.

3 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë time.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e

5 dëshmisë time.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

7 përgjegjësisë time ligjore.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe përgjegjësisë time ligjore.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Deklaroj solemnisht.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Deklaroj solemnisht Deklaroj

12 solemnisht.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se do

14 të kryej analizën si ekspert në mënyrë të ndërgjegjshme.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Se do të kryej analizën si ekspert

16 në mënyrë të ndërgjegjshme.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

18 me aq sa di.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe me aq sa di.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

21 se do të jap përfundime dhe mendime të sakta dhe të plota.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe se do të jap përfundime dhe

23 mendime të sakta dhe të plota.

24 DËSHMITARI: W04887

25 [Dëshmitari dëshmon përmes përkthimit]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
2 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim dhe mund të
3 vijojmë me dëshminë tuaj. Do t'ja jap fjalën Zyrës së
4 Prokurorit të Specializuar dhe ata do të fillojnë.

5 Z. Prokuror keni fjalën. Vërej se keni vlerësuar se ju
6 nevojiten dy orë. Na informoni nëse ka ndonjë ndryshim për hir
7 të planifikimit

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, e nderuar Gjykatëse.

9 Pyetje nga z. De Minicis

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 PY. Mirëdita. Major jemi takuar edhe më përpara. Jam Filippo
12 De Minicis. Jam Prokuror pranë ZPS-së dhe unë do të zhvilloj
13 bërjen e pyetjeve për ju sot.

14 Ju lutem na thoni emrin dhe mbiemrin?

15 PË. Më quajnë Zbynek Dolejsi.

16 PY. Datëlindja dhe vendlindja, ju lutem.

17 PË. Kam lindur më vitin 1980, më 20 shkurt, në Liberec, që
18 është në Republikën Çeke.

19 PY. A mund ti thoni Trupit Gjykes se cili është profesioni
20 që e ushtroni tani?

21 PË. Hë për hë jam shef i departamentit të gjenetikës në
22 Institutin e Kriminologjisë së Pragës.

23 PY. Ç'nivel arsimor keni? Ju lutem, na thoni diçka për
24 studimet tuaja.

25 PË. Kam diplomë të ciklit të parë të Fakultetit të Shkencave

1 të Bërnës për diagnostikim molekular dhe qelizor. Pastaj kam
2 zhvilluar studimet e ciklit të dytë në biologji molekulare dhe
3 gjenetikë.

4 PY. Dëshiroj që t'ju kërkoj që të na shpjegoni diçka më shumë
5 në përgjithësi se për çfarë kanë pasur të bëjnë kryesisht
6 studimet tuaja, duke filluar me të parën. Çfarë studiohet në
7 kuadër të diplomës për diagnostikim molekular dhe qelizor?
8 Pra, cili është objekti i këtyre studimeve?

9 PË. Objekti në përgjithësi është gjenetika e përgjithshme e
10 njerëzve, e bimëve dhe e kafshëve.

11 PY. Po për diplomën e ciklit të dytë, pra më të lartë, që
12 është gjenetikë -- biologjia molekulare dhe gjenetika? Cili
13 është objekti i këtyre studimeve?

14 PË. Krahas lëndëve të shkencave të përgjithshme këto studime
15 janë fokusuar sidomos në biologjinë molekulare, që do të
16 thotë, zbulimi i proceseve molekulare brenda qelizave të cilat
17 kanë një ndikim në transkriptimin edhe ndryshimin e qelizave
18 njerëzore.

19 PY. Në kuadër të studimeve tuaja, studimet tuaja përfshinin
20 edhe studimin e materialit gjenetik dhe ADN-së tek njeriu?

21 PË. Më së shumti, më shumë se gjysma e kohës i kushtoj
22 kësaj në universitet gjatë studimeve që unë i kam kryer.

23 PY. Sapo na thatë që aktualisht jeni shef i departamentit
24 gjenetik në Institutin Kriminalistik të Pragës. Sa kohë po
25 bëhet që punoni për këtë institut?

1 PË. Kam filluar të punoj në Institutin e Kriminalistikës në
2 vitin 2004 dhe vazhdoj të punoj prej atëherë në këtë institut.

3 PY. Ju lutem t'u tregoni gjykatësve se çfarë është Instituti
4 i Kriminalistikës të policisë të Republikës Çeke? Çfarë bën ky
5 institut?

6 PË. Në Republikën Çeke ka disa laboratorë kriminalistikë
7 pranë policisë së Republikës Çeke. Shtatë syresh janë në
8 vartësi të Institutit të Kriminologjisë. Ky institut i
9 kontrollon. Ky institut përpunon aktekspertizat, bën këqyrjet
10 kriminalistike të ekspertit për kryeqytetin, Pragë, dhe për të
11 gjitha njësitë policore të Republikës Çeke të cilat janë në
12 funksion të të gjithë territorit, që mbulojnë të gjithë
13 territorin, siç është për shembull qendra Kundër Lëndëve
14 Narkotike dhe Kriminologjisë të Organizuar.

15 PY. Harrova që t'ju pyes, a bëni ju pjesë në forcën policore
16 të Republikës Çeke?

17 PË. Po.

18 PY. Çfarë grade keni ju në forcat policore?

19 PË. [Nuk ka përkthim]

20 PY. Nuk e morëm përkthimin.

21 PË. Kolonel.

22 PY. Faleminderit. Instituti juaj, Instituti Kriminalistik, i
23 Kriminalistikës, pra, a është i lidhur me ndonjë ministri të
24 qeverisë Çeke? Pra, punon në kuadër të ndonjë ministrie?

25 PË. Instituti i Kriminologjisë është në vartësi të

1 Presidiumit të Policë që është në vartësi të Ministrisë të
2 Brendshme.

3 PY. Instituti i Kriminalistikës a bën pjesë në ndonjë rrjet
4 ndërkombëtar të instituteve të shkencave kriminalistike?

5 PË. Po. Patjetër, që në kohët në të cilat jetojmë është e
6 domosdoshme. Instituti i Kriminologjisë prej vitit 1998 bën
7 pjesë në organizatën NFC që është Rrjeti Evropian i
8 Institucioneve Kriminalistike dhe Shkencore. Më saktë është
9 ENFSI.

10 PY. Dhe kjo anëtarësi çfarë do të thotë? Do të thotë për
11 shembull që bëhet bashkëpunim edhe me institutet e huaja
12 kriminalistike?

13 PË. Është pjesë e bashkëpunimit edhe kjo do të thotë shkëmbim
14 informacioni, miratim i procedurave të përbashkëta. Qëllimi
15 është që të gjitha këto institucione të kenë një qasje të
16 përbashkët sa i takon mënyrës më të mirë drejt arritjes së
17 rezultateve të mira.

18 PY. Instituti i Kriminologjisë, puna që ai bën, a përdoret në
19 procedurat penale të Republikës Çeke? Pra, a merret ky
20 institut edhe me këtë lloj pune?

21 PË. Po. Të gjitha opinionet tona si ekspertë, aktekspertizat
22 dhe produktet tona përdoren rëndom në procedurat gjyqësore.
23 Janë pjesë e materialeve provuese. Njëherazi kemi të drejtë që
24 të kryejmë rishikim të deklaratave dhe të aktekspertizave të
25 ekspertëve të tjerë.

1 PY. Na treguat se cili është pozicioni juaj i punës. Pra,
2 jeni shef i departamentit të gjenetikës. Na thoni ju lutem, ku
3 konsiston puna juaj. Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tuaj
4 si shef i departamentit të gjenetikës në Institutin e
5 Kriminalistikës në Pragë?

6 PË. Krahas veprimtarisë standarde si ekspert, unë bëj edhe
7 kontroll të punës së kolegëve, siguroj funksionimin dhe punën
8 e departamentit tonë.

9 PY. Puna juaj, a përfshin edhe analizat e ADN-së?

10 PË. Po. Sigurisht kjo është një veprimtari standarde si
11 ekspert.

12 PY. Dhe në kuadër të punës suaj a keni dhënë ndonjëherë
13 dëshmi në gjykatë, sa i takon analizave të ADN-së që mund të
14 keni kryer ju apo kolegët tuaj në laborator?

15 PËRKTHYESI: Përkthyesit kërkojmë që pyetja të përsëritet,
16 faleminderit.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sigurisht.

18 PY. Në kuadër të punës tuaj, a keni dhënë ndonjëherë dëshmi
19 përveç ditës së sotme në një gjykatë lidhur me analizat e ADN-
20 së të kryera nga ju apo nga laboratorit juaj?

21 PË. Po. Kjo është pjesë e punës tonë që të mbrojmë
22 konstatimet tona përpara Gjykatës.

23 PY. Faleminderit kolonel. Tani përfunduar me pjesën e
24 formimit tuaj profesional dhe do të kalojmë tek pjesa e disa
25 raporteve.

1 A keni bërë një raport për identifikimin e ADN-së në
2 dhjetor 2009 lidhur me të cilin të kam kontaktuar vitin e
3 shkuar?

4 PË. Po

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani dua që të kërkoj që të
6 shfaqet raporti në ekran. Numri i identifikimit është ERN
7 SITF00012453 deri në 00012464. Ky është versioni në gjuhën
8 çeke. Pra është raporti në gjuhën çeke. Dhe sa i takon
9 versionit në anglisht dëshiroj që të shfaqet në ekran versioni
10 që është i rishikuar, dokumenti me numër identifikimi
11 SITF00012456 deri në 12458-ET.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
13 çfarë arsye po kërkon që të paraqitet raporti i tij?

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne e kemi thërritur këtë
15 dëshmitar që të japë dëshminë e tij si ekspert për këtë
16 raport. Kështu që së pari dua t'i tregoj dëshmitarit që është
17 raporti i shkruar prej tij dhe pastaj do të vazhdoj me disa
18 pyetje të tjera.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull.

21 Znj. Sekretare ju lutem vazhdoni me shfaqjen në ekran të
22 raporteve të cituara më sipër.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, kalojeni te faqja tre
24 dokumentin, në versionin në gjuhën çeke. Besoj në faqen tre.
25 Jo, kjo është faqja katër, ju kërkoj ndjesë, gabimi im. Po.

Dëshmitari: W04887 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 17

1 Kjo është faqja e duhur.

2 PY. Kolonel, a është ky raporti që keni hartuar në dhjetor të
3 vitit 2009?

4 PË. Po, besoj se po.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 6 të
6 dokumentit, ju lutem?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Dëshmitar a është gjithçka e qartë për juve?

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, është. Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Vazhdoni më tej z. Prokuror.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

13 PY. Kolonel a shikoni faqen në ekran që ka emrin tënd dhe a e
14 njihni nënshkrimin e vënë mbi emrin?

15 PË. Po, po është nënshkrimi im.

16 PY. A jeni ju personi që e keni bërë analizën që përshkruhet
17 në këtë raport?

18 PË. Po.

19 PY. Ju lutem, a mund t'i thoni Gjykatës se cila ishte detyra
20 juaj? Domethënë çfarë lloji analize ju është kërkuar, analizë
21 kjo e cila pasqyrohet në raportin që keni përpara.

22 PË. Ishte një kërkesë standarde ku na u kërkua që të bënim
23 përcaktimin e lidhjes biologjike ku na u dha material i
24 caktuar referencë ndaj prindërve të mundshëm biologjikë dhe
25 një fragment të një materiali të një trupi të caktuar të

Dëshmitari: W04887 (Seancë private)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 18

1 vdekur.

2 PY. Ju lutem, a mund të kalojmë në seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Vazhdoni, Prokuror

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretares që
11 të lëvizni një faqe më përpara te raporti. Ngrijeni pak sipër
12 versionin në gjuhën çeke, ndërkohë që i referohem këtu faqes
13 dy në versionin në anglisht të këtij raporti. Një çast të
14 nderuar Gjykatës, sa të orientohem.

15 PY. Dëshmitar, jemi akoma në seancë publike.

16 Dëshmitar na treguat se shqyrtimi ose vlerësimi që ju
17 kërkua që të bënit ishte një vlerësim standard ku morën
18 materiale reference të dy personave që mund të ishin ose që
19 ishin prindërit potencialë biologjikë nga një person nga i
20 cili morët një material tjetër reference.

21 Në qoftë se do t'i referoheni paragrafit 2 të raportit që
22 keni përpara, ju shihni aty që për sa i takon vlerësimin
23 ekspert janë paraqitur këto tre materiale. A janë këto tri
24 materiale, materialet që keni shqyrtuar për hartimin e këtij
25 vlerësimin të aktekspertizës?

1 PË. Po.

2 PY. Në raport thuhet se:

3 "Të gjithë materialet e referencës janë dorëzuar të
4 gjitha së bashku në gjendje të padëmtuar në institutin e
5 kriminologjisë në Pragë në 8 shtator 2009."

6 Ju lutem a mund të na shpjegoni pak se çfarë do të thotë
7 kjo? Pra ky citimi që materialet ju janë dorëzuar në kushte të
8 padëmtuara. Çfarë do të thotë kjo në qoftë se mund të na e
9 sqaroni?

10 PË. Çdo herë raportet që ne hartojmë, në aktekspertizat që ne
11 hartojmë, neve tregojmë se materialet e referencës kanë qenë
12 të dëmtuara apo jo. Kjo do të thotë që të gjitha kutitë, të
13 gjithë zarfet e dorëzuara, apo çdo material që kemi marrë ka
14 qenë i mbyllur dhe nuk është se ka qenë i dëmtuar. Domethënë,
15 nuk ka pasur fare asnjë lloj dëmtimi të materialit gjatë
16 transportit.

17 PY. A mund t'i tregonit Trupit Gjykses se çfarë keni bërë me
18 këto materiale në mënyrë të tillë që të mund të bënit këtë
19 aktekspertizë që ju ishte kërkuar që të hartonit?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
21 lutem, prisni një çast z. Dojlesi.

22 Znj. Sekretare, a mund ta zmadhoni pak?

23 Është më mirë edhe për juve z. Prokuror?

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, në fakt është më mirë
25 kështu në versionin e zmadhuar.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull. Vazhdojmë. Do ju kërkoja që t'ja bënit edhe një herë
3 pyetjen z. Dolejsi.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, do ta bëj.

5 PY. Pra, Dëshmitar, juve ju kërkuam që të përcaktonit në qoftë
6 se kishte lidhje biologjike ndërmjet personave që ishin burimi
7 i këtyre materialeve që morët.

8 Ndërkohë që -- pra duke u munduar që t'i jepni një
9 baraspeshë hollësive shkencore që keni dhënë në raportin tuaj,
10 a mund t'i tregoni Trupit Gjykes se cilat janë hapat
11 pasardhës që keni marrë në mënyrë të tillë që të përmbushnit
12 detyrën me të cilën ishit ngarkuar?

13 PË. Sa i takon materialit të referencës së dy personave, ajo
14 çfarë bëmë ne është që izoluan ADN-në, e nxorëm ADN-në nga
15 materialit i referencës dhe më pas përcaktuam profilin e ADN-
16 së të fragmentit të indit, sepse indi në fjalë tregonte shenja
17 lagështie. U vendos në një aparat në një kuti që në fakt
18 merret me tharjen e indit. Domethënë është një lloj tharëseje.
19 Sepse ishte e vështirë që të thahej indi në fjalë. Kjo është
20 diçka e cila në fakt ndodh goxha shpesh, kur për shembull
21 yndyrat lipide -- dhe në atë moment ndodh ajo që quhet
22 saponifikim.

23 Ky është procesi dhe në vetvete ky është provë që ky
24 fragment skeletor është marrë, është ekstraktuar si kamion dhe
25 mënyra e marrjes është e tillë që pritet kocka me një lloj si

1 sharre edhe ndërkohë ajo çfarë prodhohet nga kocka, domethënë,
2 ai pluhuri i kockës hollohet në një solucion të posaçmen për
3 dekalcifikimin e vet dhe në këtë mënyrë ne marrim qelizat për
4 të përcaktuar se cila është ADN-ja.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Dolejsi, që ta kuptojmë ne, nëse flet për provat e
7 saponifikimit, a na e shpjegon pak çfarë do të thotë kjo? Ju
8 lutem mundohuni që të na e shpjegoni sa më shpejt që të jetë e
9 mundur që ta kuptojmë. Pra, në mënyrë që e kuptojnë njerëzit e
10 zakonshëm.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Kjo do të thotë që kocka gjatë të
12 gjithë kohës ka qenë e rrethuar me substancë të lagështa në
13 sipërfaqe. Dhe për shkak të faktit që gjendja ishte kaq e
14 keqe, i ka kaluar shumë procese të ndryshme të kampionit dhe
15 ne na duhet që të merreshin disa kampionë në mënyrë të tillë
16 që të paktën të merrnim pra ADN-në e këtyre kampionëve.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

18 PY. Pyetja e radhës është kjo: A ja dolët që të nxirrnit
19 profilin e ADN-së nga kocka?

20 PË. Po, arritëm që të nxjerrim një profil të kufizuar të ADN-
21 së. Kjo do të thotë që ne nuk kemi pasur mundësi që të
22 përcaktojmë të gjithë markerat që zakonisht i nënshtrohen
23 analizës së AND-së. Markerat që kemi analizuar ne, në terma të
24 zakonshëm është që ne kemi matur gjatësinë e ADN-së, të
25 seksionit të ADN-së, dhe sa të gjatë janë këto seksione. Sa më

1 i gjatë të jetë seksioni i ADN-së aq më shpesh ata degradojnë
2 në kampion të tillë. Kështu që bëhet e pamundur që të
3 përcaktohet ekzaktësisht sesa është gjatësia e tyre.
4 PY. Na treguat që nuk ishit në gjendje që të përcaktohet të
5 gjithë markerat që zakonisht i nënshtrohen analizës. A mund të
6 na thoni ju lutem sesa markera janë gjithsej që maten
7 zakonisht ose në mënyrë ideale për një analizë të tillë, pra
8 për analizën e ADN-së?

9 PË. Në atë kohë ne kemi përdorur një kit që quhet PowerPlex
10 16, dhe në emër ose në emërtimin e kitit përcaktohet ose
11 përmbahet numri i markerave që kemi përcaktuar, identifikuar.

12 PY. Domethënë 16 është numri i markerave, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Në rrethanat që na përshkruat, sa markera patët mundësi
15 që të analizonit si të nxjerra prej asaj kocke?

16 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Avokat, përpara sesa të vijmë më tej, natyra e pyetjes është e
19 tillë që do të ishte më mirë që të nxjerrim nga salla
20 dëshmitarin, apo mund të qëndrojmë në sallë?

21 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, ka të bëjë me transkriptin, i
22 kërkoj ndjesë kolegëve, po ndonjëherë vazhdon pak më tej sesa
23 ajo që përmendet nga eksperti, duke përmendur gjithashtu edhe
24 gjakun apo kockat, të cilat nuk përmenden specifikisht nga
25 eksperti. Ne këtu kemi ind dhe kemi materialet. Kështu që do

1 të ishte më mirë që të ishte i kujdesshëm kolegu që të
2 përdoret ekzaktësisht i njëjti formulim dhe të njëjtat termat
3 nga eksperti.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
5 mund të na jepni vendin ekzakt në transkript ku bëhet fjalë
6 për këtë gjë sepse jam dakord me juve. Domethënë është momenti
7 i duhur për të ndërhyrë dhe për të korigjuar disa gjëra në
8 qoftë se do të jetë e nevojshme.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Në faqen 16, rreshti 9, ku
10 kolegu im i nderuar përmendi gjakun, ndërkohë që eksperti nuk
11 e përmendi fare këtë lloj materiali biologjik për subjektin A
12 dhe B. Kjo mund të sqarohet që ideja është që nuk u sugjerua
13 ose nuk u përmend fare nga eksperti. Këtë duhet ta bëjë
14 eksperti. Së dyti, sa i takon indeve të panjohura mendoj se
15 deri tani kemi përmendur ind, domethënë eksperti thjesht
16 përmendi indet asgjë tjetër.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Prokuror.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk jam shumë i sigurt për
20 gjakun, por sa i takon kockës, kocka është përmendur në raport
21 dhe eksperti përmendi edhe prerjen e kockës në disa copëza ose
22 në disa kampione në mënyrë që mund të nxirrej ADN-ja.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Kështu mendoj që e dëgjova edhe unë.

25 Mbrojtësi i Viktimave.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pra, fjala "kocka" përmendet në
2 faqen 19. Në rreshtin 9 dhe në rreshtin 10.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa i
4 takon kockës, avokat a u shpjeguaz, e morët shpjegimet e
5 nevojshme lidhur me përdorimin e kësaj fjale?

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Në rregull, tërhiqem nga përdorimi
7 i fjalës kockë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Prokuror, mund të sqarojmë llojin e indit që është
11 dërguar në laborator dhe që është përdorur për aktekspertizën.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, lidhur me dy subjektet e
13 njohura.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
15 po, për sugjerimet e duhura.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

17 PY. Kolonel, ti na the që për subjektet e njohura pra ADN-në
18 e nxorët nga një copë kocke. Çfarë materiali biologjik keni
19 nxjerrë lidhur me përcaktimin e profileve lidhur me këta dy
20 persona. Domethënë me subjektin A dhe personin B? Çfarë
21 materiali tjetër biologjik keni marrë prej tyre?

22 PË. Nga përshkrimi thuhet që ne na është dhënë një gjurmë e
23 kuqe dhe e kaftë në tekstil, në një copë tekstili. Në atë kohë
24 ne kemi marrë materialin e referencës në mënyrë standarde,
25 domethënë ose kemi marrë një kampion, tampon pështyme nga

1 goja, ndërkohë që ndonjëherë ajo çfarë jepet si material
2 reference është, për shembull, gjaku.

3 Këto shenjat që na janë dhënë neve janë testuar sa për
4 përcaktuar në qoftë se kishte gjak aty me një material që
5 quhet homofon që përcakton në qoftë se kishte gjak në këtë
6 material apo jo.

7 PY. Thatë gjak?

8 PË. Ndërkohë që po përpiqeshim që të përcaktonim në qoftë se
9 bëhej fjalë konkretisht për gjak njeriu, nuk po përpiqeshim që
10 të përcaktonim se çarë grupi ishte gjaku dhe i jepnim
11 përparësi analizës gjenetike, se analiza gjenetike është më e
12 saktë. Për qëllime gjenetike nuk është aq shumë e rëndësishme
13 që të përcaktohet në qoftë se materiali referencës është gjak
14 ose pështymë ose ind ose spermë. Nuk është e rëndësishme kjo.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Prokuror, nuk u shkrua në transkript pyetja që bëre, kështu do
17 t'ju kërkoja që ta përmendnit edhe një herë pyetjen që bëtë
18 për procesverbal. Thjesht për t'u reflektuar në transkript.

19 Dhe do e udhëzoja Dëshmitarin që t'i japë një përgjigje
20 pyetjes tuaj sepse ju e kërkuat specifikisht që të jepte një
21 përgjigje.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

23 PY. Pyetja që u bë: Në qoftë se pate mundësi që të
24 përcaktosh në qoftë se materiali biologjik ishte gjak apo jo.
25 Ju na shpjeguat që gjaku nuk është kaq shumë i rëndësishëm sa

1 mund të mendohet në pamje të parë. A e dini për sqarim për
2 procesverbal, në qoftë se materialet e marra nga personat e
3 njohur, pra në qoftë se ky material ka qenë gjak apo ka qenë
4 ndonjë material tjetër, a ju kujtohet kjo?

5 PË. Ne nuk kemi kryer një test specifik për gjakun e
6 njerëzve.

7 PY. A keni pasur mundësi që të nxirrni profilet e ADN-së nga
8 tamponët e personave të njohur?

9 PË. Po. Përcaktuam plotësisht profilet e ADN-së së këtyre
10 subjekteve.

11 PY. Më lejoni t'i kthehem edhe një herë pyetjes që bëra më
12 përpara, para sesa të ndërpriteshim. Na treguat se në çfarë
13 gjendje ishin kampionët e kockave. Na treguat edhe procedurën
14 që kaluat në mënyrë që të përcaktonit profilin e ADN-së. A e
15 nxorët më në fund profilin e ADN-së nga ai material kockor?

16 PË. Po. E nxorëm. Sikurse e thashë edhe më përpara ne arritëm
17 që të nxirrnim thjesht një profil të pjesshëm të ADN-së.

18 PY. Po na e thatë edhe më përpara këtë gjë. Na thatë që në
19 mënyrë ideale në atë kohë me softuerin që po përdornit -- me
20 materialet që po përdornit, m domethënë kërkonit që të
21 identifikonit 16 markera. Sa markera keni arritur që të
22 nxirrnit nga ajo kockë në mënyrë që të përcaktonit ADN-në?

23 PË. Ne ja dolëm që të përcaktonim 9 markera autozomalë. Pra
24 nga ADN-ja autozomale.

25 PY. Na treguat më herët që përcaktuat profil të plotë të

1 subjektit A dhe B. Dhe që patët mundësi që të identifikonit 9
2 markera nga fragmenti apo nga ajo copa e kockës që shqyrtuat.
3 Me këto të dhëna a patët mundësi që të përcaktonit në qoftë se
4 kishte lidhje gjaku ndërmjet kësaj copës së kockës edhe
5 personave, subjekteve A dhe B, të cilat ju i përmendët më
6 herët?

7 PË. Po. Në atë kohë ne kemi përdorur përlllogaritë tona dhe
8 nuk kemi përcaktuar asnjë marker që do të përjashtonte lidhjen
9 e gjakut ndërmjet -- domethënë lidhjen prind ose pasardhës ose
10 fëmijë. Edhe e kam fjalën këtu për lidhjen ndërmjet kockës dhe
11 dy subjekteve që ju morën materialin përkatës të referencës.

12 PY. Çfarë përfundimi arritët juve, pra cili ishte përfundimit
13 juaj i aktekspertizës në qoftë se mund të na e shpjegoni me
14 fjalë të thjeshta? Pra, në qoftë se kishte lidhje gjaku
15 ndërmjet kësaj copës së kockës dhe materialit të referencës të
16 marrë nga subjekti A dhe subjekti B?

17 PË. Besoj se këtë mund ta gjeni në faqen pasardhëse të
18 aktekspertizës time.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po sigurisht. Ju lutem
20 Sekretare a mund të kalojmë në faqen tjetër dhe të shohim
21 gjetjet e raportit të ekspertizës, aktekspertizës së
22 ekspertit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
24 Sekretare, ju lutem kalojeni më poshtë raportin, një faqe më
25 poshtë.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Ne arritëm në përfundimin që bëmë
2 një krahasim të profilit të ADN-së nga subjekti A dhe subjekti
3 B dhe po ashtu themi në këtë aktekspertizë që kjo përkon me
4 donatorin e fragmentit të kockës. Probabiliteti që ne
5 llogaritëm duke përdorur softuerin tonë është 1 me 70.000
6 domethënë, niveli i probabilitetit ishte 1 me 70.000, që do të
7 thotë që 1 me 70.000 individë të përzgjedhur rastësisht nuk do
8 të përjashtohesh nga të qenit prejardhës potencialë të dy
9 subjekteve që kemi shqyrtuar. Në të njëjtën kohë, për shkak të
10 cilësisë së kockës së marrë, ne bëmë rekomandime që të
11 prodhohet një kafkë sepse ne mendojmë që pjesa e kafkës -- që
12 të na jepej, domethënë, një fragment i kafkës ose një fragment
13 i dhëmbëve sepse këto do të na bënë të mundur që të marrim
14 një profilizim më të mirë të ADN-së. Dhe në qoftë se do të
15 marrim një kampion nga këto dy pjesë atëherë profili i ADN-së
16 do të ishte 100 për qind i saktë.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
18 PY. Kam edhe dy pyetje të tjera për të përfunduar lidhur me
19 këtë raport. Pyetja e parë është në qoftë se kemi marrë ndonjë
20 material nga kafka, domethënë ndonjë material kockor të marrë
21 nga kafka apo ndonjë kampion tjetër që ishte me cilësi më të
22 mirë krahasimisht me cilësinë e kockës që kishit marrë më
23 herët për të bërë analizën ose aktekspertizën tuaj.

24 PË. Nuk jam në dijeni të faktit që Instituti i Kriminologjisë
25 ka marrë ndonjë kampion tjetër në lidhje me këtë rast

1 specifik.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse më
3 lejoni dhe do të përpiqem që ta paraqes me gjuhë të thjeshtë
4 probabilitetin statistikor. Unë i kam bërë pyetjen dhe nuk dua
5 të jem sugjestionues por dua ta pyes dëshmitarin nëse e kam
6 kuptuar si duhet.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Vazhdoni.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
10 PY. Për sa i përket probabilitetit statistikor që na tregoni
11 ju, unë kështu e kuptoj dhe më trego nëse e kam gabim apo jo.
12 Ajo që na thanë ishte që ju keni, pra, testuar atë fragmentin
13 e kockës që ju është dhënë për të treguar nëse është e
14 subjektit A apo subjektit B dhe keni treguar mundësinë e
15 afërsisë së lidhjes mes tyre.

16 Këtë -- sesa të afërt janë mund ta shohim përmes testit
17 statistikor që ne kemi treguar. Në këtë mënyrë e kuptoj unë se
18 në qoftë se do të merrnit një fragment apo të zgjedhësh 70.000
19 njerëz në mënyrë rastësore dhe nga secili prej tyre të marrësh
20 një fragment eshtrash apo kockash nga pikëpamja statistikore
21 vetëm njëri prej tyre nuk përjashtohet të jetë subjekti A apo
22 subjekti B, kështu e kam kuptuar. E kam kuptuar në mënyrën e
23 drejtë apo jo?

24 PË. Po, ashtu është.

25 PY. Unë kam përfunduar pyetjet lidhur me raportin tuaj të

1 vitit 2009.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
3 Sekretare mund t'i hiqni dokumentet nga ekrani.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. Në vitin 2023, a keni bërë ju personalisht një analizë të
6 re lidhur me lidhjen e mundur biologjike midis Subjektit A dhe
7 Subjektit B nga njëra anë dhe personit të cilit i përket ajo
8 copë eshtre apo kocke?

9 PË. Po.

10 PY. A ke shkruar raport lidhur me këtë analizë të dytë?

11 PY. Po. Ishte pjesë e asaj përgjigje që unë kam dhënë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, të vendosim në ekran
13 raportin duke ndjekur të njëjtën procedurë që kemi ndjekur
14 edhe me raportin paraprak. Do ta jap numrin rendor tani.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 Sekretare, vendosni sapo të keni numrin e referencës.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Numri i referencës është 110670
18 deri në 110674. Të nderuar Gjykatës, këtë e kemi vetëm në
19 gjuhën angleze jo në gjuhën çeke, e kemi edhe në gjuhën
20 shqipe.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka
22 nevojë që ta vendosim në ekran atë variant, vazhdoni.

23 Faleminderit, znj. Sekretare.

24 Vazhdoni z. Prokuror.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

1 PY. Ju thatë që po e bëtë këtë, ishte pjesë e përgjigjes
2 tuaj.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në fakt, nga raporti ju lutem
4 që ta zmadhojmë pak. dakord.

5 PY. Në fillim të raportit thuhet që më është dërguar mua edhe
6 keni përmendur edhe kërkesën time që kam dërguar me email me
7 datën 22 dhjetor 2022.

8 Kolonel, a mund t'i shpjegoni Gjykatës sesi e keni bërë
9 këtë analizë të dytë?

10 PË. Raporti fillestar ishte i printuar dhe në bazë të
11 rregullave tona të brendshme ky raport është shkatërruar pasi
12 kanë kaluar 10 vite. Megjithatë, ne, të dhënat fillestare
13 arritëm që t'i siguronim sërish që do të thotë që i kishim në
14 formë numerike profilet e ADN-së. Nga -- gjuha e shkencës
15 mjeko-ligjore apo kriminalistike zhvillohet në mënyrë me hapa
16 shumë të mëdhenj që është shumë e kënaqshme për mua dhe kjo na
17 ka siguruar metoda të reja me anë të së cilës mund të
18 vlerësojmë nga pikëpamja statistikore rezultatet tona.

19 Në vitin 2009 ne kemi përdorur softuerin Excel për
20 analizat tona, për llogaritjet tona. Tani këtë e bëjmë me anë
21 të aplikacioneve të tregut, të softuerit të tregut të cilat
22 tashmë i kemi në dispozicion dhe prandaj këto përlllogaritje
23 tani i kam bërë përmes softuerit CODIS, që është edhe softuer
24 në përdorim të përgjithshëm. Është program elektronik që
25 përdoret nga shumica e laboratorëve të shkencës mjeko-ligjore.

1 Dhe rezultatet që dolën si rezultat i përdorimit të tij
2 ishin të tilla: probabiliteti apo shkalla e probabilitetit për
3 sa i përket lidhjes biologjike ishte 99.99998 për qind. Që në
4 gjuhë të thjeshtëzuar do të thotë që 1 prej 11 milionë
5 individë të zgjedhur rastësoret nuk përjashtohet të jetë një
6 pasardhës i mundshëm i këtyre dy subjekteve.

7 Në të njëjtën kohë, mund të thuhet edhe diçka që nuk
8 ishte në raportin e parë të ekspertëve, që analiza e
9 kromozomit Y në subjektin A ka rezultuar të jetë e njëjtë me
10 atë të personit B. Për sa i përket këtij fragmenti të kockës,
11 në vitin 2009 ne nuk e thamë një gjë të tillë në raportin
12 tonë. Pse? Pasi nuk ishim në gjendje që ta kishim këtë si
13 pjesë të rezultateve dhe përlllogaritjeve tona statistikore.
14 Ajo ishte një analizë tjetër mbështetëse.

15 Kromozomi Y vjen nga babai që do të thotë që babai dhe i
16 biri kanë të njëjtin profil të kromozimit Y. Ky nuk na
17 mundëson që të identifikojmë individë, por një grup. Dhe
18 prandaj, ne nuk e kemi përmendur në raportin tonë fillestar
19 këtë fakt. Ky informacion na ka ndihmuar që të bëjmë
20 konfirmimin e rezultateve në atë kohë.

21 PY. Tani kam një pyetje vijuese. E para është të dhënat që i
22 keni shfrytëzuar për të arritur në këtë rezultat prej 99.99998
23 për qind, a janë këto të dhënat të cilat i keni pasqyruar në
24 raportin tuaj?

25 PË. E keni fjalën për raportin e parë të vitit 2009?

1 PY. Jo, të dhënat e profilit të ADN-së të cilat i keni
2 shfrytëzuar për të bërë këto përllogaritje të reja, a janë të
3 paraqitura në raportin që na keni dërguar? A janë të
4 paraqitura në hollësi në raportin e dërguar?

5 PË. Profilet e ADN-së të dy subjekteve dhe profilet e
6 pjeshme të ADN-së janë pjesë e shtojcës së bashkangjitur në
7 këtë raport.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, të nderuar Gjykatës a
9 mund të kalojmë në faqen 3.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
11 është bërë tashmë, aty është, duket.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

13 PË. A janë këto të dhënat që keni shfrytëzuar për
14 përllogaritjet tuaja z. Kolonel?

15 PË. Po.

16 PY. Këto të dhëna a mund të shfrytëzohen nga një ekspert
17 tjetër, një palë e tretë, për të verifikuar saktësinë e
18 rezultateve të pasqyruara në raportin tuaj?

19 PË. Sigurisht, po.

20 PY. Ndoshta jam vetëm unë kurioz, por edhe Gjykatësit po
21 kështu. Shoh që në tabelë në të majtë shkruhet Locus, dhe nën
22 këtë kolonë ka nën të rreshta që fillon me D3S, D19, D2S. A po
23 na thoni këtu që nga këto kampionet e kockës keni arritur që
24 të siguronit nëntë shënjes, nëntë markues?

25 PË. Po. Këto janë nëntë treguesit autosomal.

1 PY. Faleminderit. Pyetja e dytë ka të bëjë me analizën e
2 kromozomit Y, për të cilin i treguat Trupit Gjykues. A keni
3 bërë një analizë të veçantë krahasuar me atë që keni bërë kur
4 keni arritur në përfundimin që ka lidhje biologjike në masën
5 99.9 për qind?

6 PË. Po. Analiza standarde për të përcaktuar profilin e ADN-së
7 përcakton edhe shënjesit e kromosomeve të ndryshme. Kur bëhet
8 analiza a kromozomit Y ne përpiqemi të gjejmë se kush është
9 locus-i i një kromozimi të vetëm. Dhe kjo aspekti pro dhe
10 kundër i kësaj analize të këtij kromozomi, pasi me të
11 përcaktohet thjesht pasardhësia mes meshkujve.

12 Analizat e tanishme që bëhen me këtë softuer të ri
13 arrijnë që ta përcaktojnë edhe këtë fakt duke treguar edhe
14 gjasat e afërsisë. Pra, është një qasje e ndryshme e analizës
15 statistikore të rezultatit që kemi arritur.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 1 të
17 raportit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Para
19 se të bëjmë këtë z. Prokurori dua që në rreshtin 22 të faqes
20 30, ndoshta në rreshtin, në fund të rreshtit 21 kur thoni:

21 "Kur bëhet analiza e kromozomit Y, ne përpiqemi të... dhe
22 tregohet shënjesit..."

23 Fjalinë nuk e dëgjova të plotë. Ndoshta nuk është
24 përkthyer tërësisht, apo transkriptuar tërësisht.

25 Mbase mungon fjala "të përcaktohet".

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me sa kuptoj, megjithëkëtë, le
2 të pyesim dëshmitarin.

3 PY. Kolonel, po përpiqem të sqarojmë transkriptin dhe këtë
4 shkencore me qëllim që të arrijmë ta kuptojmë.

5 Në transkript thuhet:

6 "Kur bëhet analiza e kromozimit Y ne përpiqemi markuesit,
7 apo locus-in e një kromozimi të vetëm".

8 Këtë kemi shkruar apo shënuar në transkript. Kjo ishte
9 përgjigja juaj, ose ju lutem a mund ta riformuloni edhe një
10 herë që ta shkruajmë apo shënojmë si duhet?

11 PË. Ju kërkoj ndjesë. Nuk e shoh dot përgjigjen time
12 fillestare, prandaj nuk di se cilën pjesë të tekstit keni
13 ndërmend.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, ndoshta
15 është më mirë që ta bëj pyetjen duke i treguar dëshmitarit
16 sesi e kam kuptuar unë, për të parë nëse mund ta sqarojmë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
18 sugjeroja ose mund të ndjekim procedurën tuaj.

19 Shoh që është larguar z. Shala, dhe nuk do të vazhdojmë
20 më tutje pa parë se ç'ka ndodhur.

21 Z. Dolejsi, i akuzuari, z. Shala nuk është i pranishëm me
22 videolidhje dhe prandaj e kam pezulluar.

23 Z. Shala, u kthyet?

24 Z. SHALA: [Përmes videolidhjes] Më falni, por pata nevojë
25 urgjente për tualet.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
2 Faleminderit, z. Shala. Herën tjetër do të lutem të na
3 informoni, të na tregoni se duhet të jeni i pranishëm pasi
4 është shumë e rëndësishme nga pikëpamja jote, që të mund të
5 ndiqni të tërë këtë proces, pavarësisht faktit që këtu janë
6 avokatët tuaj mbrojtës.

7 Z. Prokuror, propozoj që ta bëni pyetjen e dytë dhe të
8 marrim përgjigjen e z. Dolejsi.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

10 PY. Atëherë po e bëj pyetjen edhe një herë, pasi është mënyra
11 më e lehtë, ashtu siç e sugjeron edhe Gjykatësja.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
13 kërkoj ndjesë z. Prokuror pasi mora disa udhëzime teknike
14 këtu.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 PY. Pyetja që ju bëra më parë dhe të cilën ju kërkojmë që ta
17 ripërsërisni është nëse analiza e kromozimit Y është e
18 ndryshme nga analiza me anë së të cilës keni arritur që të na
19 tregoni shifrat 99.998 për qind?

20 PË. Po, është analizë dytësore, mbështetëse, që bëhet për të
21 përcaktuar lidhjen, afërsinë e lidhjes.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Prokuror, sugjeroj që t'i tregoni dëshmitarit sesi e keni
24 kuptuar ju këtë frazë dhe të shohim se çfarë përgjigje do të
25 na japë dëshmitari. Pra, është në faqen 30, rreshti 21 deri në

1 23.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

3 PY. Unë me sa kuptoj unë që për të bërë analizë standardi
4 shikonit treguesit në një numër kromozomesh. Ndërkohë që për
5 sa i përket kromozomit Y, ju shikoni vetëm treguesit e një
6 kromozimi, kromozimit të vetëm të Y-së?

7 PË. Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit, z. Dolejsi.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
11 shikojmë rezultatet që paraqiten në faqen 1.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
13 Sekretare, ju lutem ta vendosim në ekran

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pak më poshtë. Përndryshe
15 shkronjat janë mjaft të dallueshme.

16 PY. Pyetja ime është e ngjashme me atë që ju bëra lidhur me
17 rezultatet e paraqitura në raportin e parë të cilat ju dhanë
18 shifrën 1 nga 70.000. Me gjuhë të thjeshtë, kjo është -- kjo
19 të jep një mundësinë apo probabilitetin e 1 nga 11 individë të
20 zgjedhur në mënyrë rastësore. Pyetja është, sa për ta sqaruar,
21 që në qoftë se merret një fragment kocke nga 11 milionë
22 persona të përzgjedhur në mënyrë rastësore, nga pikëpamja
23 statistikore vetëm një rast është ai i cili përjashtohet nga
24 kjo lidhje biologjike.

25 PË. Shiko, -- ashtu kuptohet, ashtu duhet të kuptohet po, po.

1 PY. Na treguat përse keni bërë këtë analizë të veçantë të
2 kromosomeve. Përse të kromosomeve Y, përse? Kjo analizë që
3 keni bërë, si qëndron krahasuar me analizën e mëhershme?

4 PË. Rezultatet e analizës së kromozomit Y, shfrytëzohen edhe
5 për përllogaritje të tjera statistikore, si për shembull,
6 probabiliteti është një -- mënyrë e probabilitetit
7 statistikore ku shikohet përputhja e treguesve standardë dhe
8 probabiliteti i kromozomit Y.

9 PY. Që ta kuptojmë atë që po thoni. Raporti i ngjashmërisë që
10 nxirrnë përmes analizës standarde, pjesë e paragrafit 4, pra,
11 shifra 99.9 për qind, kjo është ajo të cilën ju e tregoni si
12 probabiliteti i ngjashmërisë?

13 PË. Jo, jo. Është një llogaritje statistikore e shfrytëzuar
14 në vitin 2009, ku kërkuam probabilitetin e përputhjes
15 rastësore. Ndërkohë që në këtë probabilitet të ri jemi
16 përpjekur të sqarojmë për publikun sesi një grup i madh --
17 njerëz nga ky grup i madh njerëzish të mund të gjejmë në
18 mënyrë rastësore një është që do të tregojë mundësinë e një
19 pasardhësi. Aktualisht Instituti i Kriminalistikës për të
20 përcaktuar lidhjen biologjike shfrytëzon një procedurë
21 standarde që quhet edhe raporti i probabilitetit, apo shkalla
22 e probabilitetit që paraqet rezultatet statistikore në një
23 kolonë të vetme.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 faqen 34, rreshti 13, pyetja "Si mund t'i interpretojmë këto

1 rezultate për sa i përket kësaj analize", nuk më duket që
2 morëm përgjigjen e duhur. Megjithatë, po lë juve që ta
3 trajtoni këtë, po nuk më duket sikur kemi marrë përgjigje

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dakord, znj. Kryetare. Kjo do
5 të jetë pyetja ime pasuese.

6 PY. Analiza e kromozimit Y, a i mbështet apo jo rezultatet që
7 ju keni nxjerrë përmes metodologjisë standarde?

8 PË. Po. Analiza e kromozomit Y është -- tregon të njëjtin
9 kromozom të personit A dhe fragmentit të kockës. Pra, mbështet
10 këto rezultate.

11 PY. Nëse i kombinon apo i analizoni së bashku këto dy analiza
12 për të arritur në një shifër të caktuar, si do të ndikojë kjo
13 në rezultatin që është nxjerrë me 11 milionë personat të
14 zgjedhur në mënyrë rastësore?

15 PË. Probabiliteti 1 në 11 milionë është për t'u dhënë juve
16 idenë e qartë. Bëhet fjalë për eksponentin 6 në shifrën 11. Në
17 qoftë se i kombinojmë këto dy rezultatet të ngjashmërisë
18 arrijmë në këtë model statistikor, ku krahasohen dy hipoteza,
19 thënë në mënyrë të thjeshtëzuar. Hipotezat janë që këto dy
20 persona janë apo nuk janë prindërit e personit që analizohet.

21 Në këtë rast, sikur të kishim në peshoren e drejtësisë dy
22 pjata dhe t'i krahasonim ato -- në këtë rast ne s'i kombinojmë
23 rezultatet e analizës standarde që na nxorën rezultatin
24 99.998, dhe rezultatet e analizës së kromozomit Y arrijmë në
25 një rezultat i cili mbështet hipotezën e përforcon atë, në

1 kupton që ato janë prindër. EkspONENTI 1 në 10 tregon që nuk
2 janë prindër. Kur shfrytëzohen rezultatet të tilla
3 alternative, ka edhe kundërshtim. Është një model ky
4 statistikor standard i cili është pjesë e softuerit CODIS.
5 PY. Nëse e kam kuptuar si duhet, dhe më tregoni nëse e kam
6 gabim, e kam kuptuar gabim. Në qoftë se kombinon analizën
7 standarde me analizën e kromozimit Y, mundësia e lidhjes
8 prindërore është 1 me fuqi 10 më e ngjashme sesa e kundërta?
9 PË. Po. Hipoteza që të janë prindër është 1 me fuqinë 10 më e
10 fuqishme sesa analiza thjeshtë e ADN-së.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E shoh që ka ardhur koha për
12 pushimin tonë, megjithatë më kanë mbetur vetëm dy pyetje për
13 të bërë përpara se të përfundoj pyetjet e mia kryesore.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
15 mirë të bëjmë pushimin tani, dhe të vazhdojmë pas pushimit.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dakord.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Dëshmitar, tani do të marrim gjysmë ore pushim, takohemi pas
19 pak. i kërkoj znj. Sekretare që t'ju shoqërojë nga salla e
20 gjyqit. Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
23 marrim pushim 30 minuta.

24 --- Pauza fillon në orën 11.01

25 --- Seanca rifillon në orën 11.30

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
2 se jeni rikthyer. Vërej se ZPS-ja ka të njëjtën përbërje,
3 Mbrojtësi i Viktimave dhe ekipi i Mbrojtjes.

4 Shoh që dhe z. Shala është gjithashtu me ne.

5 Më dëgjoni mirë, z. Shala?

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj shumë
7 mirë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit. Le të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit.

10 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin
11 në hyjë në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 [Dëshmitari dëshmon përmes përkthimit]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Z. Dolejsi, mirë se jeni rikthyer.

17 Do t'ia jap sërish fjalën z. Prokuror që të vijojë me
18 pyetjet e tij.

19 Z. Prokuror, keni fjalën.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
21 Gjykatëse. Më kanë mbetur vetëm nja dy pyetje dhe pastaj i bie
22 që do ta kem kryer.

23 PY. Z. Kolonel në faqen 28 të transkriptit të ditës sot,
24 thatë se në vitin 2009 keni përdorur programin Excel për
25 përllogaritjet, ndërsa tani keni përdorur një software të

1 posaçëm për këto lloj llogaritjesh që quhet CODIS, kështu
2 është?

3 PË. Po.

4 PY. Desha t'ju pyes diçka lidhur me aktekspertizën e vitit
5 2009.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem që të nxirrni në ekran
7 dokumentin me numër SITF00012453 në faqen -- besoj është faqja
8 në versionin çek është faqja 2 -- faqja 5 e dokumentit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 lutem mund të vazhdoni, znj. Sekretare.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe kjo, të nderuar Gjykatës,
12 është faqja 2 e versionit në anglisht. Një sqarim për mua që
13 mbase do ta ndihmojë dhe Trupin Gjykses.

14 Nëse mund të presim paksa poshtë. Po, është në rregull
15 për anglishten. Po edhe për versionin çek.

16 PY. Tek "Metodat", rubrika e dytë, në paragrafin e tretë, ju
17 keni përmendur PowerPlex 16 nga shoqëria Promega. A mund t'i
18 shpjegoni Trupit Gjykses çfarë është PowerPlex 16? Se unë me
19 sa kuptoj keni përdorur programin Excel për përlllogaritjet e
20 asaj kohe, prandaj dhe desha t'ju pyes që t'ia sqaroni Trupit
21 Gjykses, desha t'ju kërkoj t'ia sqaroni Trupit Gjykses se
22 çfarë është kjo PowerPlax?

23 PË. Për metodikën tonë, ne përdorim kite të ndryshme,
24 kimikate, solucione të ndryshme. Dhe në këtë metodikë, ne kemi
25 përmendur paketën, kitin e lëndëve kimike që është përdorur

1 për analizën autosomale. Aso kohe, ne mendonim se në treg
2 ekzistonin vetëm këto dy firma, të cilat përdorshin në
3 biosisteme, të cilat besoj se jepnin një kit Identifiler dhe
4 një firmë tjetër që quhej Promega e cila ofronte kitin apo
5 kompletin PowerPlex 16. Është thjesht një emërtim tregtar i
6 këtij kompleti kimikatesh që analizon shënuesit që i kemi të
7 nevojshëm.

8 PY. Nëse mund të më sqaroni, për çfarë përdorni PowerPex 6
9 dhe për çfarë përdorni fletën në Excel?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 PowerPlex 16?

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. 16.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Kemi përmendur vetëm kompletet
14 tregtare të cilat përdoren nga programi në laboratorin tonë.
15 Makrot e përdorur në Excel. Excel-in ne e përdorim vetëm për
16 të përlllogaritur probabilitetin e përputhjes së lidhjes së
17 gjakut, pra, lidhjes farefisnore. Nuk përmendet këtu është një
18 makro që e përdorim në Excel.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

20 PY. Pra, me sa kuptoj, ky PowerPlex 16 përdoret në procesin e
21 nxjerrjes së profileve të ADN-së, ndërsa programi Excel
22 përdoret për të përlllogaritur lidhjen farefisnore, pra,
23 familjare, në bazë të ekstraktit që ju keni nxjerrë. Kështu
24 është?

25 PË. Po, po mund të thuhet edhe kështu.

1 PY. Kam edhe një pyetje të fundit sa i takon aktekspertizës
2 së vitit 2023.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran
4 dokumentin me numër U110670.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
6 lutem, znj. Sekretare, mund të vijoni.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faqja e dytë.

8 PY. Desha që t'ju -- jo më herët ju pyeta më saktë nëse i
9 keni bërë vetë analizat dhe e keni nxjerrë këtë aktekspertizë,
10 po këtu shoh që ka nënshkruar kolonel Libor Predota, Shef
11 Divizioni. A mund të na thoni se kush është koloneli Libor
12 Predota dhe ç'rol ka luajtur në hartimin e kësaj
13 aktekspertize?

14 PË. Pyetjet që ju i dërguat zyrës sonë, policisë së
15 Republikës Çeke, janë përpunuar në mënyrë standarde, për to
16 është punuar në mënyrë standarde dhe është përpiluar
17 dokumentacioni nga presidiumi i policisë dhe ma merr mendja që
18 koloneli Libor Predota është shef i drejtorisë së
19 marrëdhënieve me jashtë. Instituti i Kriminologjisë, më saktë,
20 presidiumi i policisë ia ka përcjellë kërkesën tuaj drejtorisë
21 sonë. Kemi punuar me të dhe kemi nxjerrë përgjigjen. Dhe ky,
22 si të thuash, është garantuesi i përkthimit zyrtar apo i
23 përpilimit zyrtar dhe jua ka përcjellë juve këtë pastaj.

24 PY. Faleminderit, z. Kolonel.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Këto ishin të gjitha pyetjet e

1 mia, të nderuar Gjykatës.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Prokuror.

4 Kemi përfunduar pyetjet që z. Dolejsi ia ka bërë ZPS-ja.

5 Përpara se të vijojmë, do t'i kërkoj znj. Sekretare të
6 Gjykatës të na japë numrat ERN që u janë caktuar materialeve.
7 A nuk janë bërë shënime. Në rregull. Nuk është e nevojshme që
8 të bëhet.

9 Pastaj do të vazhdojmë me Mbrojtësin i Viktimave.

10 Keni pyetje?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

12 Pranojmë dëshminë siç e ka dhënë Koloneli dhe nuk kemi pyetje
13 lidhur me të.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.

16 Atëherë i drejtohem Ekipit Mbrojtës.

17 Znj. Avokate, dëshironi që të vijoni me kundrapyetjet?

18 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

19 Gjykatëse. Patjetër.

20 Pyetje të palës tjetër nga Znj. Cariolou:

21 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

22 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Më quajnë Leto Cariolou. Do t'ju
23 bëj disa pyetje në emër të z. Shala që ishte i akuzuari në
24 këtë çështje gjyqësore. Do t'i përqendroj pyetjet e mia
25 kryesisht tek metodika juaj, fillimisht dëshiroj që të sqaroj

1 dy çështje.

2 Siç e kuptoj dhe na e keni konfirmuar edhe më përpara dhe
3 është në faqen 11, rreshtat 15 deri 16 të transkriptit, se pas
4 vitit 2004, pra, prej vitit 2004, ju punoni në drejtorinë e
5 gjenetikës të Institutit të Kriminologjisë të Republikës Çeke.
6 E saktë është kjo?

7 PË. Po.

8 PY. Do t'ju lutesha që t'u shpjegoni Gjykatësve se çfarë
9 përvoje keni ju konkretisht për analizën e lidhjeve familjare?

10 PË. Më vjen keq. Po nuk e kuptoj konkretisht se çfarë keni në
11 mendje kur e bëni këtë pyetje?

12 PY. Aktekspertiza juaj jep një raport probabiliteti sa i
13 takon lidhjes familjare. Do të doja që ta ndihmoni Trupin
14 Gjykues me përvojën tuaj sa i takon analizës së lidhjes
15 familjare.

16 PË. Ju kërkoi ndjesë. Po nuk e kuptoj pyetjen saktësisht.
17 Mbase mund ta riformuloni me fjalë të tjera?

18 PY. Aktekspertiza juaj fokusohet në një probabilitet që
19 personi A dhe personi B kanë lidhje familjare me njeri-tjetrin
20 në bazë të analizës tuaj. Ju lutem na shpjegoni cila është
21 përvoja juaj për hartimin e aktekspertizave të tilla për
22 analizën e lidhjeve familjare.

23 PË. Është një metodë standarde në fushën e gjenetikës dhe,
24 besoj, që prej vitit 2017, Instituti i Kriminologjisë
25 identifikon të gjithë kufomat e paidentifikuara në Republikën

1 Çeke. Mbështetur në udhëzimet e drejtorit të përgjithshëm të
2 policisë.

3 PY. Pra, kjo sa i takon përvojës së institutit tuaj për të
4 bërë një analizë të tillë. Po për ju vetë? Mund të na thoni
5 diçka më shumë lidhur me njohuritë tuaja si ekspert për këtë
6 lloj analize siç e keni paraqitur edhe në aktekspertizë?

7 PË. Tani kështu i papërgatitur nuk mund t'ju jap numrin e
8 saktë të rasteve për të cilat kam punuar.

9 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Kalojmë tani tek sqarimi i
10 dytë që desha të sqaroj me ju.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
12 Avokate, dëshiroj unë të flas, të them diçka.

13 Kjo ka të bëjë me një kërkesë që ju bëtë dje, pra, dje në
14 orën 18.04 minuta, për të shtuar dy dokumente në listën e
15 materialeve që do të përdreshin me dëshmitarin. E kam fjalën
16 për dokumentet me numër 113508 dhe 113509, ky është i pari.
17 Dhe pastaj DPS00162 deri në 000236.

18 Jua miratojmë këtë kërkesë, znj. Avokate, sepse të dyja
19 materialet janë nxjerrë dhe ndërkohë nuk kemi marrë
20 kundërshtim nga ZPS-ja apo nga Mbrojtësi i Viktimave. Mund t'i
21 përdorni për kundrapyetjet.

22 Dhe këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht nga unë.

23 Mund të vazhdoni.

24 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

25 Gjykatëse.

1 PY. Z. Dëshmitar, kam kaluar në sqarimin e dytë. Instituti
2 juaj a është i akredituar në përputhje me standardet ISO sa i
3 takon besueshmërisë së analizave dhe kalibrimit?

4 PË. Po.

5 PY. Në cilin vit është akredituar ky institut në
6 përputhshmërinë me standardet ISO?

7 PË. Nuk mund t'jua them tani datën e saktë. Ma merr mendja
8 viti 2010 do ketë qenë. Jo, më falni, nuk mund t'ju jap një
9 datë të saktë. Thjesht do të jepja një hamendje.

10 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Arsye pse ju pyes sepse nëse
11 nuk e kam gabim, raporti i vitit 2023, pra, aktekspertiza e
12 këtij viti nuk e përmend nëse jeni i akredituar në
13 përputhshmëri me kriteret e standardeve ISO, apo jo? E kam
14 fjalën për aktekspertizën e vitit 2023.

15 PË. Mund të jetë e mundshme. Kjo ishte një përgjigje
16 standarde ndaj një kërkesë për informacion. Korrespondencat
17 normale nuk përfshijnë zakonisht, nuk e përmendin, pra,
18 akreditimin tonë.

19 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Të vijojmë tani me një temë
20 tjetër sa i takon aktekspertizës të vitit 2009.

21 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Dhe i lutem Sekretares që të
22 nxjerrë në ekran një raport me numër --

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
24 Avokate, këtë kërkesë ma drejtoni mua. Unë pastaj i jap lejen
25 Sekretares, i them asaj që ta nxjerrë në ekran. Të ndjekim

1 këtë procedurë, do të jetë më e lehtë.

2 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
4 të vazhdoni, znj. Sekretare.

5 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Numri ERN është SITF00012453,
6 nuk duhet të transmetohet publikisht. Nëse fokusohemi në faqen
7 2, në pjesën e sipërme, në pikën 2.

8 PY. Z. Dëshmitar -- ja një moment sa të dalë. Z. Dëshmitar,
9 në këtë pjesë ju rendisni materialet e paraqitura apo të
10 dorëzuara për këqyrje, kështu është?

11 PË. Po.

12 PY. Pika e parë që është shënuar këtu është shënuar me emrin
13 e një individi mashkull, të cilin më përpara e quajtëm me
14 shkronjën A, pastaj e dyta është materiali i marrë nga një
15 individ femër që e kemi quajtur personi B. Siç e thamë më
16 përpara nuk duhet që t'i përmendim emrat, publikisht. Tani në
17 aktekspertizën tuaj, ju keni thënë se materialet i janë
18 dorëzuar institutit tuaj në shtator të vitit 2009. A mund ta
19 konfirmoni këtë ju lutem?

20 PË. Po.

21 PY. Aktekspertiza nuk përfshin informacion nëse personat A
22 dhe B janë identifikuar përpara se të merrej kampioni, kështu
23 është?

24 PË. Jo, nuk e përmban këtë. Nëse subjekti kërkues -- mund të
25 vazhdoj apo jo? Mund të vazhdoj?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
2 unë një pyetje për ju, znj. Avokate.

3 Po z. Dolejsi, ju mund të vazhdoni tani. Mundet. Mundet.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Zakonisht kur autoriteti apo
5 organi kërkues bën një kërkesë me material referues është ajo
6 palë e cila identifikon personin prej të cilit merret
7 materiali. Ne thjesht marrim kampionin. Që është i shënuar me
8 një shifër ose me diçka tjetër pavarësisht se mund të jetë
9 edhe i etiketuar me një shkronjë apo me shifër, s'na mbetet
10 neve për ta përcaktuar.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit, Dolejsi.

13 Znj. Avokate, pyetja ime e mori përgjigjen. Mjafton hë
14 për hë.

15 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

16 PY. Z. Dolejsi, aktekspertiza juaj nuk përmban informacione
17 dhe sesi janë identifikuar personat A dhe B përpara se t'u
18 merrej materiali, kështu?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
20 Avokate, ju lutem formulojeni si pyetje, se ju po nënkuptoni
21 diçka.

22 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

23 PY. Z. Dëshmitar, raporti juaj a përmban ndonjë informacion
24 sesi janë identifikuar personat A dhe B përpara se t'u merrej
25 materiali?

1 PË. Identifikimi i subjekteve përpara marrjes së kampionit të
2 materialit bazë bëhet nga pala kërkuese. Ne jemi ata të cilët
3 i përpunojmë këto kampione. Nëse e kuptova saktë pyetjen.

4 PY. Po kjo ishte pyetja ime vërtetë. A përmban aktekspertiza
5 ndonjë informacion se kush i ka marrë këto kampione?

6 PË. Nëse shohim këtë aktekspertizë që kemi përpara, nuk
7 mendoj që është aty e përfshirë.

8 PY. Raporti a shpjegon se kur dhe në ç'rrethana janë marrë
9 këto kampione?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 vend që të bëni pyetje për gjëra që nuk janë në raport, unë do
12 t'ju propozoj që të bëni pyetje për gjëra që janë të
13 përfshira në raport.

14 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] E kuptoj.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
16 po e kam shumë seriozisht këtë se është hera e tretë që ju
17 fokusoheni tek gjërat që nuk janë në raport, pra, në
18 aktekspertizë. Prandaj dhe unë dëshiroj që nëse keni sigurisht
19 pyetje, të sqaroni, të kërkoni sqarime për gjëra, të cilat
20 dëshmitari mund të na i sqarojë.

21 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Sigurisht, e nderuar Gjykatëse,
22 zinxhiri i ruajtjes së provave është shumë i rëndësishëm. Nuk
23 ka asnjë informacion në raport.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

25 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Kjo ka lidhje me këtë.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull. Po siç e shihni nuk ju nevojitet ky dëshmitar për të
3 konstatuar këtë gjë.

4 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

5 PY. Tani t'i kthehemi një teme tjetër. Elektroferograma e
6 profileve të ADN-së te peronove A dhe B është venë në
7 dispozicionin tuaj?

8 PË. Këto profile të ADN-së janë vetëm në formën numerike.

9 PY. Po kështu është. Po a janë në dispozicionin tuaj këto
10 përgjigje?

11 PË. Po, në qoftë se e keni fjalën për përfaqësimin numerik,
12 pra, për shprehjen numerike të profilit të ADN-së, janë pjesë
13 e shtojcës dhe është edhe përllogaritja e bërë nga Software
14 CODIS që është si një shtojcë e aktekspertizës të vitit 2023
15 ku është edhe shprehja numerike e profileve të ADN-së.

16 PY. Z. Dëshmitar, a pajtoheni me mua se shtojcat e
17 aktekspertizave tuaja nuk përfshijnë elektroferogramët e
18 profileve të ADN-së?

19 PË. Po, është e saktë. Nuk janë të përfshira. Nuk i kemi
20 përfshirë në aktekspertizë.

21 PY. Ju pyes a i keni në dispozicion, a ekzistojnë diku në
22 institutin tuaj, a i keni këto?

23 PË. Jo, nuk i kemi më. Vetë aktekspertiza, përfshirë të
24 gjitha dokumentet, pra, është shkatërruar pas dhjetë vitesh,
25 pra, është shkatërruar.

1 PY. Ju keni konfirmuar më herët se megjithëse formati në
2 letër i këtij raporti të aktekspertizës së shkatërruar pas
3 dhjetë vitesh gjendet, pra, ju ende keni mundësi e keni në
4 dispozicion analizën numerike në formë elektronike, kështu?
5 Domethënë, atë që keni përdorë në vitin 2023.

6 PË. Kjo është e saktë. Ky informacion numerik është i
7 përfshirë në databazën tonë.

8 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Në raport të aktekspertizës
9 ju përmendni edhe një copëz eshtre e cila u është venë në
10 dispozicion në shtator të vitit 2009. Raporti juaj nuk përmend
11 se kush e ka siguruar këtë copëz dhe nga ku.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
13 keni bërë pyetje. Ju lutem bëni një pyetje nëse dëshironi
14 lidhur me këtë copëz eshtre.

15 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Në rregull.

16 PY. Do të doja që t'i ktheheshim tani pjesës së dytë të
17 dokumentit të vitit 2009, aktekspertizës. Nëse kalojmë tek
18 pjesa e dytë që është shënuar, me fjalën "Metodë".

19 PY. Z. Dëshmitar, do presë derisa dokumenti të jetë paraqitur
20 aty.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Përpara se të vazhdojmë me dokumentin, referenca për
23 shkatërrimin e dokumentit është faqja 28, rreshtat 11 dhe 12.
24 E kemi këtë referencë tani.

25 Dhe znj. Sekretare, ju lutem. Po ju keni shkuar tashmë

1 tek faqja.

2 Ju lutem, znj. Avokate, mund të vazhdoni.

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

4 PY. Ju konfirmuat më herët në faqen 20, rreshtin 13 të
5 transkriptit, se kompleti kimik për ADN-në, që keni përdorë në
6 analizën tuaj të ADN-së është PowerPlex 16, siç e shohim në
7 paragrafi e tretë të rubrikës "Metoda"

8 PY. Për qartësinë tonë, a mund të na shpjegoni ju lutem sesa
9 pozicione të kromozomeve mund të hetohen apo këqyren përmes
10 këtij kompleti kimik?

11 PË. Ju lutem përsëriteni pyetjen?

12 PY. Patjetër. Ju e keni përmendur më përpara, por do ju lutem
13 edhe një herë, sa pozicione të kromozomit mund të përcaktohen
14 apo të këqyren përmes këtij kompleti kimik për analizat e ADN-
15 së?

16 PË. Është e mundshme që të bëhet dhe një llogaritje e
17 thjeshtë apo numërim, pra, 16 pozicione gjithsej. 15 pozicione
18 autosomale, plus autolegjin dhe plus gjashtë.

19 PY. Dua që ta përcaktoni sesi janë verifikuar alelet e
20 ndryshme që ju keni përdorur. Pra, më intereson metoda që keni
21 përdorur për identifikimin e aleleve në elektroferogramën që
22 ju i keni bërë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Avokate, ju lutem përsëriteni dhe një herë pyetjen në

1 faqen 49, rreshtat nga 20 deri në 22, sepse mendoj se ka diçka
2 që nuk u shkrua. Jo, e kam fjalën 22, 23. Mendoj se ka diçka
3 që nuk është reflektuar.

4 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Po, patjetër.

5 PY. Pyetja është kjo, në qoftë se Dëshmitari mund të na thotë
6 se si verifikohen alelet e ndryshme. Jam e interesuar për
7 pragun që përdoret nga ju ose nga instituti juaj për
8 përcaktimin e aleleve në elektroferogramën?

9 PË. Në atë kohë dhe mbështetur në verifikimet e kryera prej
10 nesh, ne kemi përdorur pragun minimal ose dysHEME prej 50 RFU
11 njësi, RFU. Sepse në profile të tilla komplekse raportohen
12 vetëm ato alele të cilat përsëriten të paktën dy herë nga tre
13 sekuenca përsëritëse.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Shkojmë përsëri tek faqja 49, është pyetja që keni bërë në
16 rreshtin 16 të kësaj faqeje, vërej që përgjigja që dhatë juve,
17 Dëshmitar, nuk është reflektuar plotësisht në transkript. Për
18 transkript, transkripti nuk është i qartë lidhur me përgjigjen
19 e dhënë nga Dëshmitari në pyetjen tuaj.

20 Pra, pyetja juaj e fundit ishte:

21 "Se sa alele mund të hetohen, pozicione kromozomesh mund
22 të hetohen?"

23 Ndërkohë që dëshmitari thotë që:

24 "Ka me një përlllogaritje të thjeshtë ose me një
25 llogaritje të thjeshtë, kemi të bëjmë me 16 pozicione

1 kromozomesh gjithsej.”

2 Pastaj thotë: “Është 15 pozicione autosomale kromozomesh”
3 dhe pastaj nuk ë përfunduar fjalia. Ndoshta tani që e lexova
4 mbase Dëshmitari është në gjendje që ta përfundojë atë çfarë
5 po thoshte më përpara.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, pozicioni i fundit kromozomal
7 është amologenin dhe ai shërben për të përcaktuar seksin e
8 personit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

12 PY. Z. Dëshmitar, a mund të konfirmoni që keni përdorur
13 kampionët nga subjekti A dhe subjekti B si dhe pjesën e kockës
14 duke përdorur 16 pozicionet e kromozomeve përmes PowerPlex 16?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë. Mund ta mbajmë dëshmitarin këtu, Prokuror?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

18 Mendoj që u tha gjatë marrjes në pyetje nga Prokuroria të
19 dëshmitarit që kanë marrë profilet e plota për subjektet A dhe
20 B dhe vetëm 9 pozicione kromozomesh për burimin e copës së
21 kockës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Ndoshta dëshiron që të bësh ndonjë pyetje tjetër pasuese?

24 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Është e mundur që të pyesim
25 dëshmitarin për të konfirmuar në qoftë se ka përdorur profil

1 të plotë për A dhe B, duke përdorur PowerPlex 16.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky
3 është raport nuk është e nevojshme ta pyesim për këtë pyetje.
4 Kështu që ju lutem vazhdoni me pyetjen tjetër. Kjo është e
5 dhënë në raport.

6 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]
7 PY. Na e thatë ose e konfirmuat dy herë më herët që keni
8 marrë një profil të pjesshëm nga copa e kockës. Kur bëtë ADN-
9 në ose profilet, kur përcaktuat profilin e ADN-së për kockën,
10 sa pozicione kromozomesh identifikuat?

11 PË. Ishte e mundur që të verifikohesh dhe besoj që kjo
12 reflektohet në shtojcën 9, pra, ishte e mundur që të
13 verifikoheshin 9 pozicione kromozomesh.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Avokat, këtë gjë e tha tërësisht Prokurori.

16 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem a mund të
17 na thoni, z. Dëshmitar, se cilat janë ato pozicione
18 kromozomesh specifike ose konkrete të cilat çuan në rezultatin
19 e dhënë në aktekspertizën tuaj.

20 PË. Nuk e mbaj mend përmendësh. Nuk e di në qoftë se mund të
21 më tregoni shtojcën tek ajo pjesa që identifikon pozicionet e
22 kromozomeve me emra, me tituj, me shkurtime, nuk e di nëse më
23 jepni mundësi që t'i hedh një sy pjesës së shtojcës edhe pasi
24 mund ta kem lexuar atë pjesë mund t'jua them ekzaktësisht sesa
25 ka qenë numri i pozicioneve kromozomike.

Dëshmitari: W04887 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Cariolou

Faqe 59

1 PY. Në shtojcën e lidhur me analizën e vitit 2009. Dhe ky do
2 të jetë ajo pjesa ose le të themi shtojca e raportit 2023, që
3 mund t'ju ndihmonte.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

5 Dëshmitar, mendoni se mund t'ju ndihmojë kjo pjesë?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 atëherë.

9 Znj. Sekretare, paraqiteni në ekran.

10 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Për referencë është dokumenti
11 me numër 110672 dhe është faqja 670 për raportin e 2023. Do ju
12 kërkoja që të përqendroheshim në faqen 3, që ka numër
13 identifikimi ERN 110672, ne kemi këtë tabelën që ka titullin
14 "Statistikat prindërore".

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
16 di në qoftë se mund ta shikoni në ekran, Dëshmitar?

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, po e shoh. Më lejoni t'ju
18 shpjegoj që në faqen parë, ku kemi pozicionet kromozome, kemi
19 markuesit individualë ose shënjesit individualë, të cilët
20 janë dhënë. Bëhet fjalë për pozicione të kromozomesh konkrete
21 të cilët janë analizuar dhe që kanë dhënë ato rezultate që
22 keni më tej në tabelë.

23 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

24 PY. Këto janë të dhëna që morët duke përdorur PowerPlex për
25 analizën e 2009 kështu. Pra, dhe njëherë më lejoni të

1 shpjegohem ndryshe. Të dhënat që keni përcaktuar në këtë
2 shtojcë janë të dhënat që keni marrë duke përdorur PowerPlex
3 16 në vitin 2009, kështu?
4 PË. Po. Po këto janë rezultatet të cilat janë përdorur më pas
5 për llogaritjet statistikore. Këtu në shtojcë tregohet përsëri.
6 Në rastin e profileve ADN të subjektit A dhe B ,jo të gjithë
7 markuesit janë të shënjuar, domethënë jo të gjithë markuesit
8 që kemi dhënë këtu janë -- jo të gjithë ata që kemi analizuar
9 janë të reflektuara këtu. Dhe kjo për arsyen se këto të dhëna
10 nuk mund të përdoren për arsye statistikore sepse nuk mund t'i
11 krahasosh me markues të cilët nuk janë marrë.

12 Kjo do të thotë që tek kjo pjesa e raportit, gjeni vetëm
13 ato markera të cilat janë përdorur për llogaritjen ose për
14 përcaktimin e lidhjes biologjike ndërmjet objekteve të
15 shqyrtuar.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Avokate, kam përshtypjen që dëshmitari nuk kuptoi
19 plotësisht pyetjen?

20 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Ose ndoshta ta përsëritësh dhe
21 njëherë këtë pyetje që bëra më përpara.

22 PY. Po mundohesh që t'iu rifreskoja kujtesën duke ju treguar
23 këtë listë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
25 jo nuk thashë këtë. Thashë që duhet që të përsërisni këtë

1 pyetje, sepse besoj që doni të merrni përgjigje për këtë

2 pyetje apo jo?

3 Ti e pyete në qoftë se e ka përdorur këtë kit apo jo, e
4 ka përdorur PowerPlex 16 apo jo? Kam përshtypjen që është hera
5 e katër që e pyesni për këtë pyetje.

6 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

7 PY. Dëshiroj të di në qoftë se të dhënat në këtë shtojcë, në
8 faqen e tretë të raportit të 2023, a janë të dhëna të cilat
9 janë marrë duke analizuar profilin përmes përdorimit të
10 PowerPlex 16?

11 PË. Po. E vërtetë kështu është.

12 PY. Atëherë pyetja ime ishte, a mund të na thoni se
13 konkretisht se cilat kanë qenë pozicionet kromozomale që kanë
14 dhënë rezultatet për analizën e aktekspertizës tuaj të vitit
15 2023?

16 PË. E keni fjalën për kampionet e referencës apo e keni
17 fjalën për kockën?

18 PY. Tani të përqendrohemi vetëm te copa e kockës?

19 PË. Pozicionet kromozomale ku kemi pasë mundësi që të
20 përcaktojmë alelet janë përmendur tek kolona në të majtë. Në
21 këta markues, ne kemi verifikuar alelet përkatëse. Nuk jam i
22 sigurtë, në qoftë se doni që t'i them ato specifikisht apo jo?

23 PY. Pra, pozicionet kromozomale që përmenden aty, në qoftë se
24 e kuptoj siç duhet dëshminë tuaj, janë pozicione kromozomale
25 që keni përdorur si rezultat, si bazën e rezultateve të

1 përdorura dhe të bëra mbi bazën e PowerPlex 16 në 2009. Sa për
2 sqarim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Atëhere ta bëjmë dhe njëherë pyetjen dhe për ne për t'u
5 sqaruar. Pyetja është në qoftë se ju po bëni pyetjen për të
6 analizuar, pra, për këtë rreshtin e parë për D3S.

7 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Në qoftë se është realizuar apo
8 jo, po flas për pozicionet kromozomale të përmendura dhe të
9 analizuara si pjesë e PowerPlex 16. Kjo është pyetja.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
11 bëtë njëherë këtë pyetje?

12 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Nëse --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
14 lutem Dëshmitar, a mund t'i përgjigjeni edhe një herë kësaj
15 pyetjeje?

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Po më kërkoni që të jap një
17 përgjigje të plotë të pozicioneve kromozomale?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Në tërësi? Atëherë nuk mendoj
20 kështu. Jo, nuk mendoj kështu, Mendoj që kemi përdorur analiza
21 të përsëritura duke përdorur dhe kite të tjera të cilat
22 asokohe, nëse nuk gabohem --

23 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Le të shkojmë hap pas hapi apo
24 jo, të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë

1 kam përshtypjen se kjo pyetje e ka marrë përgjigjen tashmë.
2 Pyetja është -- më ler një çast ta shoh dhe do t'ju bëj
3 pyetjen. Atëherë, ju lutem, Avokate, bëjani dhe njëherë
4 pyetjen dëshmitarit sipas të njëjtës formulime që e bëtë edhe
5 më përpara, në të njëjtën mënyrë që e bëtë më përpara dhe
6 pastaj le të shohin sesi do të shkojë.

7 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

8 PY. Të dhënat e lidhura me alelet e renditura në faqen 3 të
9 raportit tuaj të 2023, këto të dhëna a janë marrë nga analiza
10 që keni që keni bërë në 2009 që janë kryer duke përdorur
11 PowerPlex 16 si kit përcaktimin e ADN-së?
12 PË. Po. Tani e kuptova pyetjen tuaj. E kuptoj se ku doni të
13 dilni me pyetjen tuaj. Përgjigja është po. Ne kemi përdorur
14 PowerPlex 16 si kit në mënyrë standarde. Dhe në mënyrë të
15 tillë që të vlerësonim analiza të caktuara dhe për të
16 përsëritur analiza të caktuara, kemi përdorur pastaj si
17 plotësim edhe kite të një kompanie tjetër që është konkurrenente
18 me PowerPlex. Për momentin, nuk e di nëse ka qenë Identifiler
19 SEfiler, nuk e di sesi e kanë emrat këto marka më. Nuk e mbaj
20 mend dhe nuk mund të them saktësisht se cilat kanë qenë këto
21 kitet e tjera

22 PY. Faleminderit. E kuptoj tërësisht atë çfarë thoni.
23 Megjithatë për të ndihmuar Trupin Gjykses për të kuptuar
24 përgjigjen që na dhatë. Më parë na keni dhënë pozicionet
25 kromozomale duke përdorur PowerPlex 16 si sistem.

1 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të
2 zmadhojmë manualin e PowerPlex 16. Është dokumenti ERN
3 DPS001162.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
5 dy gjëra. E para dua të di se cili është qëllimi i përdorimit
6 të këtij dokumenti? Dhe pastaj mund të vendosim për ta
7 transmetuar apo jo.

8 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari
9 sapo konfirmoi që të dhënat që kemi këtu ose informacioni që
10 kemi lidhur me pozicionet kromozomale të dhëna në këtë faqe,
11 të renditura në këtë faqe, janë marrë jo vetëm duke përdorur
12 PowerPlex 16.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
14 lexova që për të verifikuar rezultatin janë përdorur edhe kite
15 të tjera.

16 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Sa për ta sqaruar, do kërkoja
17 që t'i tregoja dëshmitarit manualin e PowerPlex 16, për të
18 përcaktuar se cilat pozicione kromozomale janë verifikuar
19 përmes përdorimit të këtij kiti. Dhe pastaj bëhet e qartë se
20 cilat nuk mund të përcaktohen. Dhe mbi bazën e përgjigjes, ato
21 pra, të cilat nuk janë analizuar përmes PowerPlex 16 më pas do
22 të vazhdoj të ta pyes dëshmitarin sesi i ka marrë të dhënat
23 përkatëse për ato pozicione kromozomale që nuk përcaktohen
24 përmes PowerPlex.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 goftë se e keni dhënë numrin ERN, Sekretarja mund ta paraqesë
2 në ekran këtë dokument.

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja, shkojmë
4 më poshtë në tekst te paragrafi i dytë i përshkrimit. Kjo
5 është faqja e parë? Nuk e kam për këtë faqe, e kam faqen 2.
6 Shkojmë tek faqja e dytë. Këtu. Të përqendrohemi tek paragrafi
7 i dytë.

8 PY. Z. Dëshmitar, mbase mund të konfirmoni për ne se cilat
9 janë ato pozicione kromozomale që mund të konfirmohen prej
10 PowerPlex 16?

11 PË. Këto janë pozicionet kromozomale që jepen në këtë
12 paragraf, nëse e kuptova siç duhet pyetjen tuaj.

13 PY. Pra, në manual ne shohim 16 pozicione kromozomale të
14 cilat mund të identifikohen përmes PowerPlex 16, kështu? Kjo
15 është përgjigja, e kuptoj siç duhet?

16 PË. Po.

17 PY. Pozicioni kromozomal D19S433 a mund të verifikohet duke
18 përdorur këtë kit për PowerPlex 16?

19 PË. Jo.

20 PY. Faleminderit. Ju kërkoi ndjesë nuk e dëgjova përkthimin.

21 PË. Edhe mendoj që pozicioni kromozomal i dytë që të më
22 pyesësh është D19. D19 nuk përfshihet në verifikimin që bën
23 PowerPlex 16.

24 PY. Për procesverbal, D19 nuk mund të analizohet duke
25 përdorur PowerPlex 16, pra, D19S433 nuk mund të analizohet?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe D2S1338 nuk mund të analizohet apo jo?

3 PË. Jo, nuk analizohet

4 PY. Besoj që na e sqaruat, po edhe njëherë, ju lutem, në
5 qoftë se mund t'i përgjigjeni pyetjes për ta pasur të qartë
6 Trupi Gjykues sesi keni bërë verifikimin e të dhënave që kanë
7 të bëjnë me këto dy pozicione kromozomale sepse e konfirmuan
8 se PowerPlex 16 nuk bën dot verifikimin e këtyre dy
9 pozicioneve kromozomale. Mund të na e shpjegoni, ju lutem?

10 PË. Mbase mund t'i kemi mare në një mënyrë më të shpejtë. Në
11 raportin e 2009, nuk jepen të gjitha metodat që ne kemi
12 përdorur. Gjithashtu, nuk përcaktohet as cikli që përdoret për
13 prodhimin e raportit. Nuk përcaktohet as se çfarë kiti është
14 përdorur për kromozomin X, kromozomet X. Domethënë këto janë
15 të dhëna të cilat nuk janë dhënë në këtë raport.

16 Sipas mendimit tim prej ekspertit dhe në deklaratën time,
17 në aktekspertizën time si ekspert, ne nuk jemi të detyruar që
18 të japim të gjithë informacionin që përftohet përmes
19 aktiviteteve tona prej ekspertësh.

20 Sa i takon kampionëve të komplikuar, kështu që, janë
21 përdorur kite të tjera nga kompani konkurrenente për të bërë
22 verifikimin e pozicioneve kromozomale të nevojshme në mënyrë
23 të tillë që të mund të përftoheshin sa më shumë rezultate të
24 ishte e mundur. Fatkeqësisht, për shkak të faktit që ky raport
25 është shkatërruar, unë nuk mund t'ju tregoj sot se çfarë është

1 përdorur në atë kohë, pra, nuk t'i tregoj dot në mënyrë
2 prapavepruese. Nuk e di se në qoftë se ka qenë ndonjë kit
3 Identifiler apo SEfiler. Nuk mund t'jua them sot këtë gjë
4 PY. Fatkeqësisht, nuk mund të na e jepni këtë informacion.
5 Megjithatë, na e thatë më herët që duhet që të përsërisnit
6 disa herë analizën nga segmenti ose pjesa e kockës. A mund të
7 na thoni u lutem se sa herë e keni përsëritur këtë analizë për
8 kockën?

9 PË. Po. Gjithsej janë marrë pesë kampionë. Pra, gjithsej
10 sikurse e shpjegova dhe përpara kocka u pre në segmente të
11 tjera, pra, u nda në disa pjesë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
13 avokate, dëshiroj që të sqaroj diçka të thënë më herët nga z.
14 Dëshmitar.

15 Nëse e kuptuam drejt, dy pozicionet kromozomale të
16 përmendura më herët nga Avokatja e Mbrojtjes, domethënë,
17 PowerPlex 16 nuk është përdorur si kit për analizimin e tyre,
18 kështu? Me sa e kuptova prej jush dhe e kemi tani në
19 procesverbal, që ju i thatë Trupit Gjykues që:

20 "E keni përdorur kitin PowerPlex 16" dhe kjo për
21 procesverbal është në faqen 57, rreshtat nga 1 deri në 4 dhe
22 thatë që është përdorur "në mënyrë standarde dhe për të
23 verifikuar analiza të caktuara, ndërsa për të përsëritur
24 analiza të caktuara keni përdorur kite të tjera të kompanive
25 konkurrenente".

1 Pra, ky është momenti kur unë e kuptova, që kitet janë
2 përdorur për të verifikuar, domethënë, me fjalë të tjera, për
3 të kontrolluar në qoftë se rezultatet e mëparshme ishin të
4 sakta apo jo. Ndërkohë që tani nga pyetja që ju bëri Avokatja
5 e kuptoj se këto ishin teste të reja, domethënë, ishin teste
6 të bëra nga fillimi.

7 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Dëshmitari, mund të t'i
8 përgjigjet ose ndoshta mund ta udhëzojë unë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.
10 Dua të kem një përgjigje të qartë për ta kuptuar.

11 E keni ju fjalën, Dëshmitar, për të dhënë sqarimet.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit. Në mënyrë standarde,
13 PowerPlex 16 është përdorur në laboratorin tonë. Domethënë,
14 është përdorur në mënyrë standarde për të gjithë kampionët dhe
15 për të gjithë materialet e referencës. Në rrethana
16 përjashtuese, kur ka qenë e nevojshme që të gjejmë,
17 konstatojmë, verifikojmë, testojmë rezultatet, në atë rast
18 është përdorur një kit konkurrues nga një tjetër kompani, pra,
19 nga një kompani konkurruese me PowerPlex. Dhe këto kite japin
20 rezultate shumë të ngjashme. Të vetmet dallime janë që
21 pozicionet kromozomale të vëzhguara ose të analizuara prej
22 nesh janë kompozuar në mënyra të ndryshme dhe kjo na bën të
23 mundur që të marrim seksionin më të shkurtër të fragmenteve të
24 ADN-së.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

1 është se mora vërtetë përgjigje ndaj pyetjes time. Kështu që
2 do t'ua bëj edhe një herë pyetjen, mendoj që duhet të ketë një
3 mënyrë për të dhënë një përgjigje më të qartë pyetjes që bëra.

4 Pra, dy pozicionet kromozomale që përmenden nga Avokatja
5 e Mbrojtjes dhe do t'jua lexoj edhe njëherë për të qenë të
6 qartë, pra, bëhet fjalë për pozicionin kromozomal D19S433 dhe
7 D2S1338, për këto dy pozicione kromozomale, a keni përdorur
8 një kit tjetër për të bërë analizën?

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Po. Këto pozicione kromozomale
10 janë pjesë e një kiti tjetër.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë
12 ishte kjo verifikim apo ishte analizë e re, domethënë, ishte
13 analizë për të bërë verifikimin e rezultateve të mëparshme apo
14 ishte analizë e re? Nuk i kishit rezultatet për këto pozicione
15 kromozomale më herët, kështu?

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Po mendoj sesi ta formuloj më
17 qartë, në një mënyrë më të thjeshtë për t'u kuptuar. Kitet që
18 janë përdorur prej nesh, ka pjesën më të madhe të pozicioneve
19 kromozomale që janë të njëjta. Megjithatë, në qoftë se duam që
20 të verifikojmë alele, atëherë bëjmë përsëritjen e analizave,
21 në qoftë se duam të verifikojmë pozicionet kromozomale të
22 përmendura këtu, mund të përdorim PowerPlex 16.

23 Nëse përdorim kitet e konkurrentëve, kompanive
24 konkurrenente, pjesa më e madhe e tyre verifikohen, verifikohen
25 me të njëjtat rezultate që ka dhënë PowerPlex 16.

1 Në përjashtim të dy pozicioneve kromozomale --

2 PËRKTHYESI: [Përkthim] Përkthyesi nuk e kapi emrin e
3 kompanisë së konkurrenente.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Pra, vetëm dy pozicione
5 kromozomale janë të ndryshme. Atëherë sa i takon identifikimit
6 të rezultateve të D2 dhe të D19, kemi përdorur këtë kitin
7 konkurrues. Kemi përdorur këtë dy herë në mënyrë të tillë që
8 të verifikonim alelet dhe të verifikonim numrin e raportuar.

9 Alelet nuk duhet që me domosdoshmëri të verifikohen nga
10 kite konkurruese, por kërkesa ishte që të bëhet dy herë
11 analiza për konfirmimin e rezultateve. Domethënë, nuk
12 përcaktohet aty që ose duhet që të gjitha analizat të bëhen
13 nga e njëjta kompani. Thjesht kërkesa është që të bëhen dy
14 teste për të marrë rezultatet. Nuk e di sesa i qartë isha?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si,
16 atëherë besoj që na sqaruat në këtë pjesë të transkriptit dhe
17 dua që të vazhdoj me pyetjet nga Mbrojtja.

18 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Pyetja e fundit lidhur me këtë
19 çështje. Ndoshta mund të jetë me vlerë, nuk e di në qoftë se
20 Dëshmitari, mund të na thotë në qoftë se ka përdorur të dhënat
21 e dy pozicioneve kromozomale për sa i takon këtyre dy
22 pozicioneve kromozomale. Domethënë, dua të di në qoftë se ka
23 marrë dy rezultate apo jo?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
25 ta bëni këtë pyetje.

1 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

2 PY. A mund të analizoni dy pozicionet kromozomale të cilat
3 unë i përmenda pak më herët që ju i quanit D2 dhe D19 ose
4 versioni i tyre i plotë është D19S433 dhe D2S133, a keni marrë
5 të dhëna të lidhura me pozicionet kromozomale duke përdorur
6 PowerPlex 16?

7 PË. Jo, është e pamundur që të marrim rezultate për këto dy
8 pozicione kromozomale.

9 PY. Pra, vetëm shtatë nga lokuset e vendosura në faqen 3 të
10 raportit të viti 2023, pra, vetëm shtatë të tilla janë
11 analizuar me PowerPlex, kështu është? Me qëllim që të jemi të
12 saktë në atë që kemi kuptuar nga ana juaj.

13 PË. Nuk e di. A mund ta shoh edhe njëherë listën?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
15 të vendosni aneksin, shtojcën e raportit të 2023. Nëse ka
16 nevojë, Avokatja mund t'ju ndihmojë me numrin e referencës.

17 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Numri është 110672.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Më kujtohet që të gjitha këto
19 lokuse kanë pasur identifikuesin e tyre.

20 PËRKTHYESI: [Përkthim] Nuk i kam lexuar, nuk i kam kapur
21 dot të gjithë këto numra.

22 DËSHMITARI: [Përkthyesi] Nuk e di nëse janë pjesë e
23 identifikuesit, po janë pjesë e analizës së bërë nga PowerPlex
24 16.

25 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

1 PY. Një pjesë e përgjigjes suaj, z. Dëshmitar, nuk është nuk
2 është përkthyer. A mund të konfirmojmë që shtatë nga lokuset e
3 paraqitura në këtë listë nuk janë analizuar me PowerPlex 16?

4 PË. Po, po. Janë analizuar.

5 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Shtatë janë analizuar. Kërkoj
6 ndjesë. Po, po.

7 PY. Dy nuk janë, nga nëntë, shtatë janë realizuar.

8 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

10 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, kjo do të thotë të dhënat për këto nëntë
12 lokuse që janë analizuar në PowerPlex në vitin 2009 nuk janë
13 në këtë listë?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
15 është e qartë kjo. T'i japim fjalën z. Prokuror fillimisht.

16 Duhet t'i kërkojmë dëshmitarit të dali nga salla?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Vetëm të themi të qartë atë që
18 është e qartë. Kjo janë të dhënat, si mbas asaj që kam kuptuar
19 unë, janë të dhëna të vitit 2009. Këto nuk janë materiale të
20 reja të vitit 2023.

21 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Po, kështu e kam kuptuar edhe
22 unë. Po unë dua të di nga ku kanë ardhur këto të dhëna dhe,
23 mesa di unë, kemi konfirmuar se dy nga këto nëntë lokuse nuk
24 janë të sistemit PowerPlex dhe nuk e dimë se cili sistem është
25 shfrytëzuar.

1 Dua që dëshmitari të konfirmojë që duke qenë që PowerPlex
2 analizon 16 lokuse, të dhënat për nëntë këtyre lokuse nuk janë
3 në këtë listën e 2023, raporti i 2023, kështu është?

4 PË. A mund ta përsërisni pyetjen pak më qartë, ju lutem?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
6 t'ju jap të drejtën që t'i bëni pyetje dëshmitarit në të
7 gjitha këto çështje specifike, por edhe Trupi Gjykses duhet të
8 jetë në gjendje që ta ndjekë arsyetimin e pyetjeve që bëni.
9 Dhe, aktualisht, unë nuk ju kuptoj. Nuk ju kuptoj.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më lejoni të them, që
11 dëshmitari ka shpjeguar që ka shpjeguar që PowerPlex ka
12 analizuar 16 lokuse për shkak se nga kjo është ka nxjerrë
13 vetëm nëntë, ishte e logjikshme që të analizoheshin vetëm këto
14 të nënta, të cilat janë -- dy nga të cilat vijnë nga një
15 paketë tjetër konkurruese.

16 Prandaj desha dhe ta bëja të qartë që dëshmitari ka folur
17 vetëm për këto nëntë lokuse.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
19 që t'ia bëni pyetjen që doni të bëni për Trupin Gjykses që ta
20 diskutojmë.

21 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Ne kemi tashmë kemi arritur në
22 përfundimin që në PowerPlex 16 merren të dhëna lidhur me 16
23 lokuse. Dhe këtu kemi të dhëna vetëm me shtatë lokuse të
24 analizuara më PowerPlex 16. Informacioni lidhur me nëntë të
25 tjera që nuk është e paraqitur këtu --

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
2 keni fjalën shtatë dhe dy?

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] 16 janë të gjitha lokuset e
4 analizuara me 16 minus 7 që kemi këtu në listë, mbeten 9. Dhe
5 mund t'ju tregoj se për cilët bëhet fjalë. Pra, nëntë janë
6 realizuar me PowerPlex 16, por informacioni nuk është në këtë
7 raport dhe desha të dija që përse?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
9 doni që argumenti të jetë në të kundërt?

10 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Jo, është çështje e ndryshme.
11 Dua të konfirmoj thjesht që e kam kuptuar si duhet atë që
12 thotë dëshmitari.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po më
14 duket që po bëni përllogaritje vetë apo jo? Ju po thoni që
15 janë nëntë të analizuara me këtë paketë, dy nga të cilat nuk
16 janë analizuar, pasi kështu na ka thënë dëshmitari dhe janë
17 edhe gjashtë të tjera.

18 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Nëse mund t'ju ndihmoj, e
19 nderuar Gjykatëse. Këtu në shtojcë janë nëntë lokuse të
20 paraqitura, PowerPlex analizon 16. Dy nuk janë analizuar.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy
22 nga këto nëntë.

23 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Pra, shtatë janë analizuar me
24 PowerPlex 16. Atëhere mbeten 9 lokuse të tjera, të cilat nuk
25 janë aty.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
2 ju po e ktheni argumentin në të kundërt duke bërë një
3 përllogaritje? Po bëni 16 minus shtatë. Dhe nuk e shoh
4 nevojën. Në qoftë se kemi bërë gjithë këtë analizë, nuk shoh
5 që të flasim 16, nëntë, shtatë, nëntë e kështu me radhë për ta
6 bërë pyetje. Ju mund të më thoni se përse bëhet kjo pyetje, me
7 qëllim që të bëjmë këtë. Po, aktualisht, nuk e kuptoj se çfarë
8 tjetër na mundëson të kuptojmë.

9 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, desha të
10 konfirmonte dëshmitari që ka bërë këtë analizë që të dhënat
11 për nëntë lokuse, të cilat nuk kanë nevojë t'i identifikojë,
12 nuk janë të paraqitura në raportin e 2023. Këtë pyetje desha
13 t'i bëja dëshmitarit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
15 shoh njëherë nëse e kupton këtë dëshmitari.

16 A mund të më shpjegosh se përse e bën këtë pyetje? Pasi
17 me sa kuptoj unë, ti po bën një llogaritje dhe nuk besoj që
18 këtë informacion ti mund ta bësh mbi bazë të informacionit që
19 na ka dhënë dëshmitari.

20 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Keni të drejtë, e nderuar
21 Gjykatëse. Unë po bëj këtë përllogaritje, pasi nuk jam
22 eksperte dhe dua që dëshmitari të konfirmojë nëse e kam
23 kuptuar si duhet që do të thotë që ka të dhëna mbi nëntë
24 lokuse të cilat nuk janë të paraqitura këtu.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

1 jo. Jo, jo.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me sa kuptojmë ne, përgjigja
3 është dhënë. Dëshmitari ka thënë që këto lokuse nuk janë
4 analizuar këtu për shkak se ato mund të jenë marrë vetëm nga
5 subjekti A dhe B dhe jo nga fragmenti i eshtrës.

6 Dhe mbi këtë bazë nuk arritën të bëjnë analiza midis të
7 dyjave, kështu që ata analizuan vetëm ato lokuset të cilat
8 janë të disponueshme.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
10 janë nëntë dhe kjo është pikënisja. Prandaj nuk do ta lejoj të
11 bëhet këtë pyetje.

12 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Dakord.

13 Tani po kaloj ndoshta në pyetjen e fundit që kam.

14 PY. Folën për disponueshmërinë e elektroferogrameve të
15 profilit të ADN-së të A dhe B. A ekziston elektroferograma të
16 profilit të ADN-së të fragmentit të kockës? A i keni ato në
17 dispozicion në laboratorin tuaj, pra, a i keni në dispozicion?
18 PË. Jo. Ato ekzistojnë vetëm në formatin numerik, numëror, të
19 cilin e kemi paraqitur në shtojcën tonë. Këto janë rezultate
20 të paraqitura me shifra, me numra të cilat janë në thelb të
21 përlllogaritjeve tona statistikore.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Mbrojtëse, kjo pyetje është bërë në të njëjtën mënyrë dhe po
24 kërkoj të gjej referencën dhe e kam marrë këtë.

25 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Ndoshta kam pyetur për A dhe B

1 në fillim dhe tani po kërkoj për eshtrën. Ndoshta po gaboj,
2 mund ta kem gabim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Ndoshta e kam gabim unë dhe dua të kërkoj falje, mbase e kam
5 unë gabim.

6 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Jo, jo. Megjithatë i kam
7 mbaruar të gjitha pyetjet. Nuk kam pyetje të tjera për
8 dëshmitarin.

9 PY. Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
11 dëshiron Prokuroria të bëjë pyetje shtesë?

12 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje shtesë për
15 të bërë këtij dëshmitari, e nderuar Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Mbrojtësi i Viktimave?

18 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Përpara se të pyes dëshmitaren [sipas përkthimit], z.
21 Dëshmitar, a dëshironi të thoni ndonjë gjë apo të shtoni
22 ndonjë gjë përpara se t'ia jap fjalën Palës Mbrojtëse për të
23 pyetur nëse ka ndonjë pyetje tjetër për të bërë?

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Edhe njëherë më lejoni të sqaroj
25 pyetjen.

1 Në vitin 2009 në raportin tonë, ne nuk kemi përshkruar të
2 gjitha analizat, përfshirë edhe analizën e kromozomit Y. Dhe
3 kjo për shkak se e kemi arritur t'i kishim këto rezultate për
4 këto dy lokuse përmes paketës që nuk ishte PowerPlex 16.
5 Megjithatë këto rezultate janë marrë nga i njëjti kampion.

6 Ne kur e kemi kampionin ne bëjmë analiza të ndryshme.
7 Analizat janë në formën shifrore, me shifra numerike dhe këto
8 shfrytëzohen për përlllogaritjen statistikore të përafërsisë
9 biologjike.

10 Dhe shpresoj që ta kem sqaruar pyetjen që më është bërë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 [Mikrofoni çaktivizuar]

13 Faleminderit, z. Dëshmitar.

14 Pala Mbrojtëse, a dëshironi të bëni ndonjë pyetje?

15 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Dy çështje fare të vogla.

16 Pyetje vijuese të palës tjetër nga Znj.

17 Cariolou:

18 ZNJ. CARILOU: [Përkthim]

19 PY. A keni në dispozicion të dhëna nga analiza e 2009 e cila
20 nuk është përfshirë në raportin e 2023? Në çfarëdolloj formati
21 që të jetë elektronik apo çfarëdo qoftë. Pra, të dhëna nga
22 analiza e 2009 e cila është në dispozicionin tuaj sot?

23 PË. Ne kemi marrë të dhënat nga CODIS që ka të bëjë me
24 kromozomin Y dhe nuk besoj që kjo është pjesë e shtojcës. Janë
25 11 treguesit e haplotipit Y. Dhe kjo është e njëjtë edhe për

1 subjektin A edhe për fragmentin e eshtrës. Por kaq kemi
2 arritur të sigurojmë.

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Një sqarim i fare i vogël për
4 procesverbalin dhe në qoftë se nuk i shërben ndonjë gjëje
5 tjetër. Unë besoj që mund të ketë një gabim të vogël
6 ortografik në raportin e vitin 2009. Ndoshta dëshmitari mund
7 ta sqarojë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Dakord.

10 Znj. Sekretare, ju lutem ta vendosni këtë raport.

11 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Ta vendosim raportin e 2009,
12 faqen e dytë, që ka numrin rendor ERN SITF00012454. Të kalojmë
13 në pjesën që titullohet "Metoda" .

14 PY. Z. Dëshmitar, ndoshta mund të konfirmoni nëse lokusi i
15 dytë, në rreshtin e dytë, të paragrafit të tretë, ku thuhet
16 "D2S11". A është gabim ortografik? Ndoshta do të jetë "D2S11".
17 A është ky korigjimi që duhet bërë?

18 PË. Po. Është gabim ortografik. Është lokusi D21.

19 PY. Nuk kemi pyetje të tjera për të bërë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Vazhdoni.

22 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera për të
23 bërë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
25 që po korigjojmë, unë ju kërktoj ndjesë pasi në të vërtetë në

1 faqen 47, rreshti 18, ju vërtetë po flisnit për
2 elektroferogramën kur folëm për A dhe B dhe më pas folët për
3 eshtrat. Pra, sa për të korigjuar procesverbalin.

4 Tani po pyes kolegët nëse kanë pyetje për të bërë.

5 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Dëshmitar, nuk kemi pyetje të tjera nga ana e Trupit Gjykses.
8 Kjo do të thotë që dëshmia juaj para Dhomave të Specializuara
9 ka përfunduar.

10 Ju falënderojmë shumë për dëshminë që keni dhënë në këtë
11 sallë. Unë shpresoj që do të na ndihmojë në gjetjen e së
12 vërtetës. Ju uroj një udhëtim të mbarë dhe ju kujtoj që të mos
13 e diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë që keni dhënë
14 këtu dhe më lejoni edhe njëherë që t'ju falënderoj.

15 Znj. Sekretare e Gjykatës, do t'ju shoqërojë nga salla e
16 gjyqit.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit për mundësinë që të
18 shpjegoj çështje të cilat mund të kenë qenë të paqarta.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit, znj. Sekretare.

22 Përpara se të përfundojmë seancën, kemi një urdhër gojor
23 për të dhënë, siç e kam njoftuar palët dhe Mbrojtësin e
24 Viktimave.

25 Ky është një urdhër gojor që tregon kalendarin e punës

1 për hapat e ardhshëm procedural. Që ka të bëjë me përfundimin
2 e argumenteve të ZPS-së, konferencën përgatitore të viktimave,
3 shqetësimet dhe pikëpamjet e Mbrojtjes për sa i përket
4 dëshmime, Konferencën Përgatitore të Mbrojtjes dhe hapjen e
5 argumenteve të saj.

6 Dhe në bazë të nenit 40(2) të Ligjit dhe rregullave
7 9(5)(a), 116(1), rregullën 119 dhe rregullën 129 të
8 Rregulloreve.

9 Trupi Gjykses cakton ditën e mërkurë, 6 korrik 2023 si
10 data në të cilën duhet t'i përfundojë argumentet ZPS-ja.
11 Përpara se ta përfundojë argumentin e saj, ZPS-ja do të duhet
12 të paraqesë kërkesat për pranimin e materialeve sipas nenit 37
13 të ligjit apo materialeve të tjera.

14 Po kështu, përpara se të përfundojë argumentet e saj ZPS-
15 ja dhe pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të fundit të
16 ZPS-së, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave duhet të dorëzojnë
17 kërkesat për pranimin e materialeve të shfrytëzuara gjatë
18 pyetjeve që ato u kanë bërë dëshmitarëve të fundit të ZPS-së.
19 Që do të thotë dëshmitarëve të cilët do të japin dëshmi midis
20 datës 26 qershor dhe 5 korrik.

21 Kjo do të thotë që, për këta dëshmitarë, nuk do të keni
22 një javë nga përfundimi i grupit të dëshmime të paraqitura në
23 vendimin 461, paragrafi 56. Ju kërkohet që të organizoni punën
24 në këtë mënyrë. Kundërshtimet dhe vëzhgimet, nëse do të ketë
25 të tilla, do të duhet të dorëzohen brenda afatit pesë ditor që

1 kemi paraqitur në vendimin 461, paragrafi 56.

2 Në datë në 6 korrik, para orës 4.00, ZPS-ja do të duhet
3 të japë njoftim me shkrim në bazë të rregullës 126 të
4 Rregullores me anë të së cilës ta njoftojë Trupi Gjykses,
5 Palën Mbrojtëse dhe Mbrojtësin e Viktimave që nuk ka më
6 dëshmitarë për të thirrur apo materiale të tjera prove që do
7 të paraqiten dhe do ta përfundojë argumentin e saj. Dhe kjo
8 është në varësi të përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të
9 fundit të ZPS-së që ta përfundojë, pra, më datën 5 korrik apo
10 më para.

11 Mbrojtja, tani kam një pyetje për juve. Pyetja e parë që
12 kam është, nëse jeni në gjendje të njoftoni Trupin Gjykses
13 nëse dëshironi të paraqisni mocion sipas rregullës 130 të
14 Rregullores për të hedhur poshtë ndonjë prej akuzave apo të
15 gjitha apo nëse dëshironi që t'i paraqisni argumentet tuaja në
16 bazë të rregullës 119(1) të Rregullores?

17 Dhe në qoftë se pala Mbrojtës nuk është në gjendje të
18 shprehet me këtë çështje tani, në atë rast, pra, duhet të
19 njoftoni Trupin Gjykses, ZPS-në dhe Mbrojtësin e Viktimave
20 nëse keni ndërmend të paraqisni mocion në bazë të rregullës
21 130 të Rregullores për të hedhur poshtë ndonjë nga akuzat apo
22 të gjitha ato, nëse dëshironi që të paraqisni argumentet
23 tuaja, menjëherë pasi ZPS-ja të ketë dorëzuar njoftimin e saj
24 të rregullës 126 dhe jo më vonë se në të njëjtën ditë ose jo
25 më vonë se kaq.

1 Ju e keni fjalën Pala Mbrojtëse.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë preferoj që të pres përpara
3 sesa t'ju jap juve përgjigje, pasi do të jetë një përgjigje më
4 e saktë dhe kjo në datën që keni kërkuar ju.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, Avokat i Mbrojtjes.

7 Atëhere, në varësi të ndonjë kërkesë të rregullës 130 e
8 kështu me radhë, do të duhet të organizohemi për procesin pas
9 kësaj, pra, në varësi nëse do të bëhet një mocion sipas
10 rregullës 130.

11 Në qoftë se ju dëshironi të paraqisni argumentet tuaja
12 dhe për të organizuar në mënyrë më të efektshme dhe të shpejtë
13 procesin, ne do të caktojmë se këto janë hapat proceduralë dhe
14 afatet kohore për argumentet tuaja.

15 Së pari, Pala Mbrojtëse, ju do të duhet të paraqisni
16 listën e dëshmitarëve dhe të provave që të ketë informacionin
17 sipas rregullës 119(2)(a) dhe (b) të rregullores deri ditën e
18 hënë 17 korrik 2023.

19 Deri më 19 korrik 2023, duhet të lejoni ZPS-në dhe
20 Mbrojtësin e Viktimave që të analizojnë dhe të kopjojnë çdo
21 deklaratë, dokument, fotografi apo objekte të tjera të
22 prekshme të cila i ka nën kontroll Pala Mbrojtëse dhe të cilat
23 dëshiron Mbrojtja t'i paraqesë në fazën e gjykimit.

24 Do t'i jepni ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave të gjitha
25 deklaratat, nëse ka, të dëshmitarëve që ju dëshironi të

1 paraqisni, të thërrisni në sallën e gjyqit dhe të gjitha
2 deklaratat të cilat janë marrë dhe që Pala Mbrojtëse dëshiron
3 të paraqiten në gjykim dhe t'i jepni ZPS-së të gjitha provat
4 materiale që Mbrojtja dëshiron të paraqesë në gjykim sipas
5 rregullës 104(5) dhe (7) të Rregullores.

6 Mbrojtja do të duhet të bisedojë me ZPS-në përpara
7 paraqitjes së listës së provave me qëllim që të mblidhen sa më
8 shpejtë që të jetë e mundur dhe, kur është e mundur, të gjitha
9 ankesat e ZPS-së lidhur me autenticitetin e provave që do të
10 paraqesë Mbrojtja sipas rregullit 119(2)(b) të Rregullores.
11 Dhe kjo nuk dëmton mundësinë që ZPS-ja të ngrejë kundërshtime
12 lidhur me pranueshmërinë e çdo prove materiale në qoftë se ajo
13 paraqitet gjatë Trupi Gjykues në pjesën që ka mbetur të
14 gjykimit.

15 Pala Mbrojtëse po kështu duhet të zbatojë edhe udhëzimet
16 e Trupit Gjykues lidhur me vendimin mbi ecurinë e procesit,
17 vendimi 434. Në mënyrë të veçantë paragrafët përkatës 27, 28,
18 30 deri në 33, 35, 56, 64, 68 dhe 69.

19 Së dyti, kujtoj për të gjithë, por në mënyrë të veçantë
20 për Mbrojtësin e Viktimave, që Trupi Gjykues dëshiron që të
21 dëgjojë planet e Mbrojtësit të Viktimave dhe pikëpamjen dhe
22 shqetësimin e viktimave duke filluar nga data 21 apo 22 gusht
23 2023. Kjo do të varet nga sasia e kohës që kërkon Mbrojtësi i
24 Viktimave nëse do ta fillojmë në datën 22 gusht.

25 Menjëherë pas kësaj, brenda së njëjtës javë, ne

1 dëshirojmë që të mbledhim konferencën përgatitore të
2 Mbrojtjes, kjo konferencë përgatitore do të mbahet në praninë
3 e ZPS-së, Mbrojtësit të Viktimave.

4 Por, Pala Mbrojtëse, nëse dëshironi që mbani një sesion
5 *ex parte*, njoftoni Trupi Gjykues me qëllim që të ndjekim atë
6 procedurë.

7 Në qoftë se dorëzoni një mocion të rregullës 130 dhe ai
8 miratohet, ne do t'i lirojmë datat, do t'i lirojmë datat që
9 kemi në gusht dhe nuk do të ketë nevojë që të mbajmë që të
10 dëgjojmë nga Mbrojtësi i Viktimave apo të kemi ndonjë seancë
11 përgatitore të Mbrojtjes.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Më falni.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
14 falni se më duket se bëra një gabim të vogël.

15 Në qoftë se mocioni juaj i rregullës 130 do të miratohet,
16 në qoftë se dorëzoni një të tillë, nuk do të mbajmë seanca
17 dëgjimore në gusht.

18 E treta, ne caktojmë datën ditën e hënë, 18 shtator 2023,
19 për hapjen e argumenteve të Mbrojtjes. Edhe kjo do të jetë në
20 varësi të vendimit të marrë lidhur me mocionin e rregullës
21 130, nëse do të dorëzohet një e tillë.

22 Mbrojtësi i Viktimave, tani do të kthehem nga ju. Ne kemi
23 paraqitur afatet kohore për juve dhe këtu i referohem urdhrin
24 kohor të 4 majit. Ne kemi deklaruar po ashtu që, në qoftë se
25 Mbrojtësi i Viktimave dëshiron të paraqesë dëshmi apo

1 shqetësime nga ana e viktimave kjo do të paraqitet gjatë javës
2 nga 21 deri 25 gusht 2023.

3 Mbrojtësi i Viktimave, a keni nevojë për ndonjë
4 konferencë të ecurisë së çështjes për të organizuar
5 prezantimin e argumenteve tuaj dhe shqetësimet e dëshmitarëve?

6 Z. LAWS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, unë, shkurt,
7 mund të them që nuk është e nevojshme. Dhe mund t'ju tregoj se
8 ku jemi ne në përgatitjen që kemi bërë deri tani. Ne do të
9 realizojmë çdo gjë brenda afatit të 30 qershorit dhe nuk do të
10 kemi nevojë për shtyrje të këtij afati.

11 Dëshmitarët që dëshirojmë të thërrasin më datën 21 dhe 22
12 gushti janë të gatshëm për t'u paraqitur, e dinë që do të
13 vijjnë dhe ka pak gjasa që t'u kërkojmë viktimave të paraqesin
14 shqetësimet dhe pikëpamjet e tyre.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
16 mundësi që të fillojmë më datën 22 dhe të vazhdojmë me datën
17 23, pra, po e bëj pyetjen ndryshe. Ata dëshmitarë janë të
18 disponueshëm për tërë javën?

19 Z. LAWS: [Përkthim] Ne u kemi thënë dy individëve në
20 fjalë se ato do të duhet të jenë të disponueshëm më datë 21
21 dhe 22 gusht. Pasi unë mendova se këto ishin datat e caktuara
22 për këtë për dëshminë e tyre. Por jam i lumtur që t'i pyes
23 nëse ato mund të jenë të disponueshëm edhe më datën 23.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
25 do të jetë një kërkesë që vjen nga ana jonë.

1 Në qoftë se e ndryshoni mendjen Mbrojtës i Viktimave,
2 atëherë Trupi Gjykses mund të organizojë një konferencë të
3 ecurisë me datën 7 korrik. Dhe këtu po e lëmë këtë çështje si
4 një opsion, e kemi mbajtur shënim përgjigjen që na keni dhënë,
5 por thjesht që ta dini nëse ka nevojë.

6 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
8 nëse dëshironi ta bëni këtë, Mbrojtësi i Viktimave, ju lutem
9 ta njoftoni Trupi Gjykses sa më herët që të jetë e mundur.
10 Tani nuk do organizojmë asgjë, po ju lutem të na informoni në
11 rastin më të parë nëse dëshironi që të mbahet kjo konferencë.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Dakord. Po patjetër.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
14 vij në pikën e fundit.

15 Trupi Gjykses mendon se është e arsyeshme që të marrim
16 parashtrime deri të premtën, 1 shtator 2023, në pajtim me
17 rregullën 159(6) të Rregullores nga palët dhe Mbrojtësi i
18 Viktimave lidhur me çështjen nëse i akuzuari shpallet fajtor
19 për një apo më shumë se një nga akuzat e aktakuzës, pra, nëse
20 Trupi Gjykses do të duhet të japë masën e dënimit së bashku me
21 aktgjykimin apo të procedojë në përputhje me rregullën 162 dhe
22 164 të rregullores.

23 Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave do të duhet të japin
24 parashtrime edhe nëse ka dëshmi të tjera që ato duhen të
25 paraqesin për sa i për këtë dhënies së masës së dënimit,

1 përfshirë faktin nëse dëshirojnë të thërrasin dëshmitar për
2 këtë synim. Dhe kjo nuk cenon vendimin e Trupit Gjykues lidhur
3 me fajësinë ose jo fajësinë e të akuzuarit. Pra, unë po
4 paraqitem që të organizojë çdo gjë në mënyrë sa më të
5 efektshme.

6 Në qoftë se palët dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk do të
7 jenë në gjendje që t'i bëjnë këto vëzhgime në këtë fazë, ata
8 do të duhet të dorëzojnë parashtrime për të treguar arsyen për
9 këtë. Sidoqoftë, Trupi Gjykues parashtrimet mbi këtë çështje
10 do të duhet t'i marrë përpara përfundimit të argumenteve të
11 Mbrojtjes në bazë të rregullës 131 të Rregullores.

12 A është çdo gjë e qartë. Shoh që Prokurori po pohon me
13 kokë.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. E keni bërë të qartë. Unë
15 po kërkoj një sqarim me këtë rast. Në faqen 74 të
16 transkriptit, ju e dhatë datën për përfundimin e çështjes sonë
17 më datën 6 korrik.

18 6 korriku është e enjte. Dhe desha të jem i qartë, nëse
19 dëshironi që ne ta përfundojmë këtë, argumentin tonë në këtë
20 kohë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Atëhere do të jetë më 6, ditë e enjte. Pasi me sa kuptojmë ne
23 më datën 5 mund të përfundojmë dëshminë e dëshmitarit dhe
24 deshëm që t'i jepnim Mbrojtësit të Viktimave dhe ZPS-së
25 mundësinë për të përfunduar ndonjë gjë që mund të ketë mbetur

1 për sa i përket kësaj dëshmie, sidomos për sa i përket ZPS-së.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Çdo gjë është e
3 qartë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit. Faleminderit që e ngritët këtë çështje.

6 Mbrojtësi i Viktimave, është e qartë çdo gjë për juve?

7 Z. LAWS: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Më lejoni të
8 korrigjoj transkriptin lidhur me diçka që thashë unë në faqen
9 78, rreshti 17. Ku thashë:

10 "Ne do të arrijmë çdo gjë brenda afatit të 30 qershorit".

11 Dhe unë thashë:

12 "Do ta arrijmë këtë".

13 Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Pala Mbrojtëse, është e qartë çdo gjë?

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë e qartë, të nderuar
18 Gjykatës. Shumë e qartë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Këtu përfundon seanca e ditës së sotme. Në qoftë se nuk
22 ka ndonjë gjë tjetër që duan të ngrenë palët dhe Mbrojtësi i
23 Viktimave.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, asgjë më tepër.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë tjetër.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Asgjë tjetër për të shtuar.

2 Ndoshta znj. Cariolou, do të thotë ndonjë gjë?

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të
4 shtuar.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Dakord. I falënderoj palët, Mbrojtësi i Viktimave, Zyrën
7 Administrative që nuk është këtu për pjesëmarrjen e tyre. Dhe
8 falënderoj dhe njëherë përkthyesit, stenografin, sigurinë dhe
9 kabinën audiovizuale për ndihmën që na kanë dhënë gjatë ditës
10 së sotme.

11 Seanca përfundon deri më datën 26 qershor në orën 9.30.

12 --- Seanca mbyllet në orën 13.07

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25